



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **II-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2024.**

Seanca mbahet **më 23.02.2024 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon **në orën 10:00.**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S:

1. Arsytimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartje të mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2023 (ref.drejt.fin)
5. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i dytë me qytetar i mbajtur nga kryetari i komunës me datë 26.12.2024,
6. Pyetje dhe përgjigjeje.

01Nr. 06-45511 2024
Klinë, me 12.02 2024



Kryesuesi,
Fadil Gashi



Na osnovi člana 43, 45 i 47 Zakona 03/L-040 o Lokalnu Samoupravu, člana 47 Statuta Opštine Klina 01-110-1232/2010, člana 5 AU MLS broj 02-2015 o sastancima skupštine opštine i člana 4 pravilnika za rad skupštine i opštinskih komiteta, predsedavajući Skupštine Opštine vrši sledeće:

POZIV

Pozivaju se članovi Skupštine Opštine Klina i ostali zainteresovani da prisustvuju II-j sednici SO za 2024 godinu.

Sednica se održava **23.02.2024 (Petak)**, u Sali Skupštine Opštine od 10:00.

U slučaju neprisustvavanja sastanku, molimo vas da se oslonite odredbi člana 39 ZLS.

Predloženi:

DNEVNI RED:

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka,
3. Razmatranje i usvajanje preporuka Političkog i Finansijskog Komiteta,
4. razmatranje i usvajanje predlog-odluke za prenos sredstava od sopstvenih prihoda godine 2023 (ref. Odeljenje Finansija),
5. Razmatranje zapisnika drugog sastanka Predsednika sa građanima dana 26.12.2023,
6. Pitanja i odgovori,

01Br. 06-4551 /2024
Klina 12.02 /2024



Predsedavajući,
Fadil Gashi

PËR: Kuvendin Komunal, Kryesuesin e Kuvendit z. Fadil Gashi dhe Drejtorinë e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

NGA: Komiteti për Komunitete Kryesuese e Komitetit: Besiana Gashi

LËNDA: Kërkesë

DATË: 12/02/2024

I nderuar Kryesues i Kuvendit Z. Fadil Gashi dhe drejtor i Financave Z. Enver Berisha,
uroj të jeni mirë dhe që punët po ju ecin mbarë.

Unë, Besiana Gashi, kryesuese e Komitetit për Komunitete, që nga viti i kaluar, pavarësisht diskutimeve që i kemi pasur dhe kërkesës në formë ankesë me qëllim të shprehjes së pakënaqësisë për çështjen e mospagesës së anëtarëve të këtij komiteti, për të cilët tashmë jeni të informuar edhe ju, ende nuk kam marrë ndonjë përgjigje në formë shkresë zyrtare nga ana juaj si drejtori (Z. Berisha). Andaj, synimi ynë është arritja e një zgjidhje për këtë problem, i cili është me rëndësi për funksionimin e këtij mekanizmi obligativ, siç është Komiteti për Komunitete. Për këtë arsye, me mirëkuptim po kërkoj nga ju, dhe të mundësohet edhe nga kryesuesi i kuvendit (kërkesë Z. Gashi-it), që në mbledhjen e radhës të këtij muaji të na bëni një interpelancë lidhur me këtë çështje, për të marrë informacion në lidhje me hapat konkrete që keni ndërmarrë dhe të na sillni si deshmë nëse keni ndërmarrë diçka në këtë aspekt.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj, ju përshëndes.

Me respekt,

Besiana Gashi,

Kryesuese e Komitetit për Komunitete.




Për/To/Za :	Asamblenë komunale – z. Fadil Gashi
Nga/From/Od :	Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim – z. Enver Berisha
Përmes/Through/Preko :	z. Zenun Elezaj – Kryetar i KK- Klinë
Tema/Subjekt/Subjekat:	Kërkesë për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2023 në vitin 2024
Data :	

Të nderuar,

Të hyrat vetanake të vitit 2023 të cilat do të barten në vitin 2024 janë në shumën prej 942,121.66 €. Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave Ligjit të buxhetit për vitin 2024 dhe Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nga teprica e mjeteve nga viti paraprak që barten në vitin vijues paguhen obligimet nga viti paraprak sipas kontratave të nënshkruara. Nisur nga kjo propozimi ynë për shpërndarjen e tyre nëpër programet dhe nën-programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike të shpenzimeve, është si vijon:

- Paga dhe Meditje në shumën prej 45,000.00 €;
- Mallra dhe Shërbime në shumën prej 65,000.00 €;
- Shpenzimet Komunale në shumën prej 20,000.00 €;
- Subvencione dhe Transfere në shumën prej 24,149.00 €;
- Shpenzime Kapitale në shumën prej 787,972.66 €.



Në kategorinë paga dhe meditje :

Arsimi Fillor (93510), shuma prej 30,000.00 €;

Arsimi Mesëm (94710), shuma prej 15,000.00 €;

- **Arsyetim:** Bartje e obligimeve të pashlyera në mësimin për të rritur dhe obligime të zëvendësimit të mësimdhënësve të liruar nga puna për shkak të sëmundjeve të rënda.

Në kategorinë mallra dhe shërbime :

Infrastruktura Rrugore (18018), shuma prej 65,000.00 €;

- **Arsyetim:** Bartje e obligimeve të pashlyera në mirëmbajtjen e rrugëve lokale.

Në kategorinë e shpenzimeve komunale :

Drejtoria për Buxhet e Financa (17518), shuma prej 10,000.00 €;

Administrata e arsimit (92090) shuma prej 10,000.00 €.

- **Arsyetim:** Bartje e obligimeve të pashlyera për shkak të nxemjeve qendrore me pompa termike dhe rritja e tarifave për shërbimet e pastrimit.

Në kategorinë Subvencione dhe transfere :

Zyra e kryetarit (16018), shuma prej 24,149.00 €;

- **Arsyetim:** Rritja e shpenzimeve për pagesat e lindjeve dhe varrimeve .

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:

Planifikimi urban dhe inspeksion (66395), në projektet:

“Bashkëfinancim me donatorë”, kodi (48267), shuma prej 155,386.49 €;

“Ndertimi i segmenteve dhe infrastruktures nentokesore të rrugës Ymer Berisha, Drini i Bardh,Skender Rexhepi,Abedin Rexha,Mehmet Haxhaj,Haxhi Zeka”, kodi (54272), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitoksore në Cerovik-Qabiq”, kodi (54276), shuma prej 3,186.17 €;

“Ndertimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastruktures nentokesore ne Kline-Dersnik-Dolc”, kodi (54280), shuma prej 95,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitoksore ne Gremnik”, kodi (54292), shuma prej 4,900.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitoksore ne Jashanice-Jelloc-Resnik-Pogragje”, kodi (54293), shum prej 45,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitoksore ne Sferke-Volljake-Qupeve”, kodi (54300), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndertimi i shtratit te Lumit Klina, Lagjia Arberi, Burimi i Jarines-Pograxhe”, kodi (54336), shuma prej 100,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitoksore ne Gjurgjevik te Madhe”, kodi (54337), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitoksore Krusheve e Vogel(trotuari Kline-Zllakuqan)”, kodi (54341), shuma prej 30,000.00 €

“Ndertimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitoksore ne Poterq-Dugajeve-Drenovc”, kodi (54344), shuma prej 40,000.00 €;

Infrastruktura Rrugore (18018), në projektet:

“Ndertimi i rrjetit te ndriqimit publik Krusheve e Vogel-Madhe,Drenovc,Qeskove, Jashanic, Leskoc, Ranoc”, kodi (54353), shuma prej 52,000.00 €;

“Ndertimi i impijanteve per trajtimin e ujerave te zeza ne Zllakuqan, Jashanice,Shtarice,Gllareve,Radulloc”, kodi (54516), shuma prej 87,500.00 €

Sherbimet Rezidenciale (75587), në projektet:

“Ndertimi i shtepise se pleqeve ne Kline”, kodi (54463), shuma prej 100,000.00 €.

Arsimi Fillor (93510), në projektet:

“Rindertimi i objektit shkollore, Gjumnazi Luigj Gurakuqi”, kodi (54380), shuma 15,000.00 €.

Arsyetim: Në vitin 2023 dhe në vijim inflacioni e ka rritur edhe koston e shpenzimeve. Mbulimi i obligimeve kontraktuale dhe vazhdimin e projekteve të pa përfunduara.

FOLIA NOVOA	
16, 01, 2024	
Org:	st
01-586-1965 /24	

Prof. Dr. Lush Culaj,
Dega e Historisë
Instituti Albanologjik i Prishtinës
Email: lushculaj66@hotmail.com
Telefoni: +383 044 149-259

Në Klinë, më 16. 01. 2024

Për Kuvënderin e Komunës të Klinës / kryesuesin Fadil Gashin

Lënda: Propozim për dekorimin e prof. Ymer Berishës

Duke u mbështetur në pikën 40 aleneja 2 nën pikën h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 nenit 40 aleneja 2 nën pikën e 7 të Statutit të Komunës të Klinës si dhe të nenit 5 të rregullorës për përmbajtjen e simboleve komunale si dhe procedurën mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit:

I nderuari Kryesues i Kuvendit Komunal të Klinës, z. Fadil Gashi

Kam nderin dhe privilegjin që para jush të bëj propozimin për dekorim të Profesor **Ymer Berishës**, për veprën e tij të jashtëzakonshme atdhetare e politike për historinë dhe të ardhmen a Kosovës dhe të mbarë interesave nacionale.

Kam kënaqësinë që në vijim të parashtroj arsyetim-motivimin për këtë propozim.

ARSYETIM

Luftëtar për çlirimin kombëtar në Kosovë, veprimtar i lëvizjes demokratike. Lindi në fshatin Gjurgjevik i Madh, komuna e Klinës më 1912. Pas kryengritjes së vitit 1919 në Kosovë, për shkak të represionit, iku bashkë me të atin në Shqipëri. Shkollën fillore e filloi në Krumë dhe e përfundoi në Fushë Krujë. Ndoqi Normalen e Elbasanit ku pati mësimdhënës figura të çmuara të arsimit kombëtar si Aleksandër Xhuvanin, Ahmet Gashin etj. Pas diplomimit në vitin 1932, punoi për një periudhë të shkurtër si mësues në disa shkolla të Shqipërisë. Me bursën e dhënë nga shteti shqiptar vazhdoi studimet në Itali, ku përfundoi Akademinë Ushtarake dhe Fakultetin e Histori-Gjeografisë. Pas kthimit punoi si mësimdhënës në disa fshatra të rrethëve të Shqipërisë. Ishte ndër intelektualët më të shquar kosovarë në Shqipëri dhe aktivist i Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës".

Në vitin 1941 pas okupimit të Jugosllavisë nga nazi-fashizmi prof. Berisha u kthye në Kosovë ku filloi punën si mësimdhënës në Gjinnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë.

Forcat komuniste jugosllave gjatë Luftës Antifashiste kishin premtuar se kriteri kombëtar do të vihej në themel të ndarjes territoriale. Pas përfundimit të luftës këto kritere nuk u morën parasysh. Edhe pse viset shqiptare përbënin një terësi territoriale, ato u ndanë midis njësive federale Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Ky mashtrim ndikoi që tek shqiptarët të rritet

pakënaqësia. Ymer Berisha ishte major dhe pjesë e Shtabit të Shaban Polluzhës në luftën e Drenicës në fillim-vitin e vitit 1945 dhe një ndër njerëzit më të respektuar të tij.

Pas shuarjës të rezistencës të Shaban Polluzhës, Berisha mbeti njëri nga prijësit e dalluar të Rezistencës së Kosovës. Kur u duk se të gjitha shpresat e qëndresës kundër brigadave jugosllave do të ishin të kota, Ymer Berisha doli në skenë me organizimin, strategjinë dhe largëpamësinë e tij, me vullnet e qëllim të vazhdimit të rezistencës antikomuniste.

Ai kaloi në malet e Llapushës dhe nga aty filloi përpjekjet për organizimin e rezistencës. Konsiderohet njëri ndër ideologët dhe krijuesit e platformës politike për mbrojtjen e kufijve etnikë të trojeve shqiptare. Ishte luftëtar kundër fashizmit e komunizmit. Si truri dhe nervi dirigjues i levizjes ilegale kishte dhenë kushtrimin për formimin e një fronti unik politiko-ushtarak të të gjitha rrymave.

Pas fitorës të luftës antifashiste, marrëdhënjet e afërta në mes Tiranës dhe Beogradit nuk jepnin shpresa për një zgjidhje të mundshme të çështjes kombëtare të shqiptarëve në Jugosllavi. Ndoshta këto janë arsyet kryesore që sollën daljen e organizatave politike të reja me frymëzim antikomunist si ONDSH dhe "Besa Kombëtare" e udhëhequr nga profesor Berisha etj. Ai ishte përcaktuar për luftë të armatosur me program demokratik properëndimor, duke promovuar kështu edhe nacional-demokracinë e Kosovës (e cila do të bëhet model edhe për lëvizjet e mëvonshme politike në Kosovë, si ato të viteve '90).

Kuvendi i Dobërdolit i gushtit 1945 pati një jehonë të konsiderueshme në opinion. Ai e zgjodhi profesor Berishën udhëheqës politik. Në Kuvend prezantimi i problemeve që kërkonin zgjidhje nga prof. Berisha ishte shumë përbajtësor.

Prof. Berisha mbante lidhje me forcat anglo-amerikane nëpërmjet Kryezive të Gjakovës, përmes kolonel Sylejman Vuçiternës, Muharrem Bajraktarit-Bajraktarit të Lumës etj. Ata shpresonin realizimin e synimeve të tyre përmes demokracive perëndimore, prandaj nuk ishte e rastit që pranë tyre të kishte misionarë anglo-amerikanë. Veçohen letrat e profesorit që i këmbente me misionin anglez, respektivisht me gjeneralin Hadson. Në një raport me 22 tetor 1945 prof. Berisha e informonte atë për situatën e rëndë politike në Kosovë. Nga të dhënat e lartshënuara dhe burimet arkivore shihet se gjeneral Hadsoni kishte informata të konsiderueshme për gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi.

Peticioni në emër të shqiptarëve të Jugosllavisë së atëhershme për gjeneralin Hadson, kishte për qëllim që Britanisë së Madhe t'i ofrohej një pasqyrë reale mbi gjendjen e shqiptarëve. Lidhjet ndërmjet organizatës "Besa Kombëtare" dhe misionit anglez, mbaheshin me vështirësi të mëdha.

Pas Luftës së Dytë Botërore, në Evropë nuk ekzistonte ndonjë lëvizje apo parti antikomuniste më masive dhe më e organizuar se Lëvizja Nacional-Demokratike Shqiptare. Brenda një kohe të shkurtër ajo arriti t'i shtrijë degët e veta nëpër të gjitha territoret e Kosovës e më gjerë, si kundërpeshë ndaj ripushtimit të Kosovës. Kjo ishte dhe partia e cila i dha kuptim për herë të parë sistemit shumëpartiak në Kosovë, meqë doli në skenë një parti me prirje konservatore që në plan të parë kishte mbrojtjen e interesave nacionale.

Në vitet 1945-1947, në radhët e LNDSh-së të udhëhequr nga Profesor Ymer Berisha, Halim Spahia, Gjon Serreqi, Selman Riza, Marije Shllaku etj, kishte në radhët e veta mbi 30.000 anëtarë aktivë në të gjitha territoret e Kosovës, Maqedonisë e Bujanocit me rrethinë. Kjo e dhënë flet qartë se çfarë rezervash kishin shqiptarët ndaj forcave komuniste.

Në Kongresin e Lipovicës (Blinajës) të 25 korrikut 1946 u vendos që forcat nacionaliste të quheshin: *Ushtria popullore nacional-demokratike shqiptare* – UPNDSh, dhe Ymer Berisha u emërua Komandant i UPNDSh-së dhe Kryetar i tërë Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare. Në fakt detyra më e lartë komanduese e udhëheqjes aë mbarë levizjes profesorit iu dha në mungesë,

sepse ai tashmë ishte eliminuar fizikisht. Sipas të dhënave që i jep eprori komunist jugosllav Gojko Medenica, më 10 korrik të vitit 1946 në malet e Hereçit të Gjakovës, Ymer Berisha u vra, i rrethuar nga forcat e të ashtuquajturës "Mbrotjja Kombëtare" dhe e milicisë jugosllave, u vra para se të udhëtonte për në Kongresin V të ONDSH-së, që mbahej në Lipovicë (Blinisht).

Likuidimi i Ymer Berishës dhe shumë personaliteteve të njohura të Kosovës kishte si qëllim edhe frikësimin e popullsisë shqiptare të Kosovës përfshirë këtu edhe disa komunistë shqiptarë të Kosovës. Ai vdiq si vdesin trimat dhe as sot nuk i dihet varri i saktë. Uroj që brezat e ardhshëm të mësojnë të vërtetën veprimtarinë e Komandantit të Maleve Dardane, Durim Vullnetit, alias Ymer Berisha, politikan, strateg, ushtarak, filozof, gjuhëtar, historian, gjeograf, arkeolog, e mbi të gjitha humanist.

MOTIVACIONI PËR PROPOZIM-DEKORIM

Në bazë të asaj çfarë u tha më lart, del se Prof. Ymer Berisha ishte personalitet i shquar në fushën e rezistencës së armatosur kombëtare. Rrjedhimisht, i propozojmë Kuvendit të Komunës në Klinë që ta dekorojë atë për tërë veprën e tij kulturore, politike e nacionale, për tërë atë çfarë ishte e çfarë bëri:

- si dijetar, profesor e ushtarak i përmendur;
- si strateg që orientoi interesat shqiptare kah aleatët anglo-amerikanë;
- si trashëgimtar të një familje me traditë atdhetare nga komuna e Klinës;
- si një ndër Normalistët e parë të diplomuar në Elbasan nga Kosova;
- si një ndër profesorët e parë nga Kosova të diplomuar me bursën e shtetit shqiptar;
- si një ndër ushtarakët e parë të diplomuar nga Kosova me bursën e shtetit shqiptar;
- si mësimdhënës i dalluar në shkollat e Shqipërisë ku punoi;
- si një ndër të parët që u rikthye në Kosovë në vitin 1941 me krijimin e rrethanave të reja;
- si një ndër profesorët e parë të Gjinnazit "Sami Frashëri të Prishtinës" i cili po vinte bazat e një universiteti të ardhshëm të Kosovës dhe i cili la detyrën e profesorit për ta kundërshtuar ripushtimin;
- si një ndër intelektualët që tregoi rezerva ndaj komunistëve dhe vendimeve të Bujanit;
- si një ndër të parët që iu bashkua Shaban Polluzhës dhe rezistencës së tij kundër ripushtimit të Kosovës duke u bërë anëtar i Shtabit të tij;
- si një ndër intelektualët më vizionarë, me qartësi politike antifashiste dhe antikomuniste;
- si intelektual që bashkëpunoi ngushtë me ajkën nacionaliste të kohës si Halim Spahinë, Bedri Pejanin, Ferat Dragën, Marie Shllakun, Gjon Serreçin, Ukë Sadikun, Ndue Përlleshin, Sylejman Vuçiternën, Muharrem Bajraktarin etj.;
- si themelues të organizatës "Besa Kombëtare" dhe udhëheqës të saj deri në fund;
- si lider të shumë Kuvendeve Kombëtare në asaj periudhe dhe si unifikues dhe përafrues të të gjitha grupeve dhe çetave shqiptare;
- si hartues të promemorjes dërguar gjeneralit anglez Hadson ku e informonte për gjendjen e rëndë të shqiptarëve.
- ai i zgjedhur (në mungesë) udhëheqës i mbarë Lëvizjes Çlirimtare dhe Komandant i Përgjithshëm për të gjitha trevat shqiptare në ish-Jugosllavi, nga Kongresi i Lipovicës (Blinajës) më 25 korrikut 1946, pa dijeninë se ishte vrarë;
- si i përndekur dhe i vrarë në pritë më 11 korrik 1946, në Hereç të Gjakovës, nga partizanët jugosllavë;

- si i varrosur e zhvarrosur dy herë nga komunistët deri sa ia humbën varrin;
- si nderi dhe personaliteti më i dalluar i komunës të Klinës i të gjitha periudhave;
- si personaliteti i cili ka kaluar përmasat komunale dhe i takon përmasave kombëtare;
- si personaliteti më thelbësor më të cilin duhet të identifikohet Klina në arealin kombëtar;
- si personalitet që në radhë të parë Komuna e Klinës duhet të ja rikthej dinjitetin;

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal z. Gashi,

Besoj shumë se Ju dhe Asambleja Komunale do vini në vend dinjitetin e shpërfillur të Prof. Ymer Berishës, duke e dekoruar për gjithë meritat e tij të jashtëzakonshme për interesat nacionale me dekoratën **Nderi i Klinës**.

Me shumë respekt,

Prof. Dr. Lush Culaj



P. S.

*Propozimi del nga projekti i aprovuar nga Këshilli Shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës: *Ymer Berisha - jeta dhe veprimtaria atdhetare 1912-1946*.



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. _____ 2024

Klinë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 26. 01. 2024, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Pjesëmarrës në mbledhje: Anëtarët e Kuvendit të Komunës, kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, nënkryetarja e Komunës, drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të policisë së Kosovës, përfaqësues të OSBE, Mediat lokale si dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë. Kryesuesi konstatoi se prezent në mbledhje janë 24 anëtarë të Kuvendit dhe se Kuvendi mund të vazhdoj me punimet.

Hapet Debat për Rendin e Ditës.

Rendi i Ditës u MIRATUA me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave.

Prezent në mbledhje janë 24 anëtarë të Kuvendit, pritet që të bashkëngjitet edhe Arta Partina, Asdren Ramadani dhe Lirie Gashi ndërsa për Ilir Hoti mungon.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

z. Fadil Gashi, kryesues: Tek faqja e 12 nuk është se nuk është thënë nga unë por po del paksa e vrazhdë. Shkruan mes tjerave se kryesuesi propozoj që mos të diskutohet, nuk ka qëllimi im të transmetoj mesazhin e diktatit prandaj dua ta sqaroj se është thënë për shkak të miqësisë dhe afërsisë që kemi mes vete. Prandaj kërkoj që të formulohet njëjtë sikurse është thënë por duke ja hequr “kërkoj që mos të diskutojmë”.

Me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA procesverbali bashkë me vërejtën e kryesuesit.

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së.

Kryesuesi tha se janë gjithsejtë dy kërkesa që njëri nga ato e aknë bartur në zyrën e kryetarit dhe kërkesën e dytë të z. Adem Krasniqi për vendosjen e lapidarit të Shpresa Krasniqi e kemi bartur në kuvend. Kryesuesi tha se edhe pala është pajtuar që të bëhemi bashkë me shoqatat e luftës edhe me ekzekutivin dhe të gjejmë një zgjidhje të kënaqshme . E kemi parë që emri i Shpresës nuk është i gdhendur në lapidarin e martirëve të tjerë por vëllai i saj ka thënë se edhe kur është vendosur lapidari, familja nuk ka pranuar që të i shkruhet edhe emri i Shpresa Krasniqi në atë lapidar. Ata kanë kërkuar trajtim të veçantë me një lapidar të veçantë. Kryesuesi tha se ai nuk është pro që të ndahen martirët sepse të gjithë kanë rënë për një qellim dhe nga e njëjta dorë e armikut. Po ashtu z. Gashi mendon se të gjithë martirët duhet të trajtohen barabartë.

z. Esat Raci: Pajtohem plotësisht që emri i martires Shpresa Krasniqi të trajtohet barabartë me të gjithë martirët e tjerë. Të i vendoset emri i saj aty ku janë të gjithë martirët e komunë sonë. Por nëse vendoset për vendosjen e një busti unë jam prap dakord.

z. Zafer Gashi: Rasti është i ndjeshëm dhe të gjitha sqarimet që ju i dhatë kryesues qëndrojnë. Mendoj se të gjithë martirët do të duhej të kenë vend në komunën tonë prandaj unë jam për po dhe jam në dijeni që shumë shpejt do të vije kërkesa për një bust edhe për Ali Berishën iniciuar nga shokët e tij. Mendoj që nuk duhet të jemi të rezervuar por të shihet mundësia që rasteve të tilla menjëherë të ju aprovohet kërkesa dhe të shihet mundësia për të ju ofruar hapësirën e nevojshme. Jam për PO ndaj kërkesës së familjarëve të Shpresa Krasniqi.

Z. Fadil Gashi, kryesues: Po ka ardhur kërkesa për bust për Ali Berisha por nuk janë kategori e njëjtë. Ju e dini numrin e përgjithshëm të martirëve. Të gjithë jemi që të i trajtojmë por barabartë të trajtohen përndryshe nuk do të kishte hapësirë në Komunë për të gjithë bustet e martirëve. Më mirë është që të i gdhendet emri në lapidar ku janë të gjithë emrat e martirëve, duhet të jemi më të kujdesshëm si kuvend e të mos nxisim përçarje mes familjarëve të martirëve.

z. Valmir Bacaj: Përhëndetje. Sa i përket kërkesës së familjes së Shpresa Krasniqi për vendosjen e bustit në hapësirën e caktuar , duhet ta kemi parasysh se hapësira e kërkuar nuk është pronë e Komunës atëherë mbetet të diskutohet bashkërisht edhe me OVL dhe të gjendet një zgjedhje afatgjate për të gjithë martirët e Komunës sonë. Për kërkesën e dytë të parashtruar nga Mëhill Lleshaj pajtohem me rekomandimin e KPF-së dhe tek pika e tretë, Rreziku i qytetarëve nga qentë endacak ashtu siç keni thënë edhe ju , kjo çështje të diskutohet në KKSB e cila e ka edhe në plan të punës.

z. Kushtrim Haliti: Përhëndetje. E kam parë kërkesën e familjes së Shpresa Krasniqi por unë mendoj se nuk duhet behet dallim nga Martirët dhe familjarët tanë që i kemi martir. Edhe ne kemi familjar të vrarë e të zhdukur , kemi edhe dëshmorë që s` kanë asnjë bust të vendosur. Nëse aprovohet kërkesa në fjalë unë kam me bërë kërkesë tek të gjitha familjet e martirëve që të kërkojnë nga Kuvendi që të ju ndahet hapësirë veç e veç për vendosje të busteve.

z. Arben Limanaj: Përsëritje. Nëse është fjala për martirët e njëjtë sepse mund të jetë me emër e mbiemër të njëjtë edhe një tjetër martir, unë e di që një rrugë e kemi emëruar tek fabrika e farërave me emrin e saj. Pra është trajtuar mirë dhe mendoj që të gjithë martirët duhet trajtuar mirë dhe me kujdes në mënyrë të barabartë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit Arben për informacionin e dhënë, Më vjen mirë që e paskemi trajtuar mirë martirët në fjalë. Përgjigjen palës duhet të ja kthejmë se ajo hapësirë nuk është pronë e Komunes dhe do të doja që përgjigja e jonë të i shkojë palës në kuptimin e frymës së barabarësisë në trajtim të martirëve duke kërkuar mirëkuptim nga familja.

Me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA vendimi i kuvendit për përgjigjen ndaj kërkesës së familjes Krasniqi.

Me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim të gjitha rekomandimet e tjera në bllok U MIRATUAN.

Pika 4 Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar- dhjetor 2023

z. Enver Berisha, drejtor i Drejtorisë së FEZH: Përsëritje të gjithëve të nderuar të pranishëm. Ky raport i vitit të kaluar i ka dy specifika. E para është se është një tejkalim i madh që ka ndodhë në inkasimin e të hyrave vetanake dhe për këtë në radhë të parë duhet falënderuar qytetarët e komunës sonë por edhe stafin për angazhimin e tyre në maksimum. Buxheti për vitin 2023 duke përfshirë edhe të hyrat nga grandët e brendshme dhe të jashtme është 15,568,206.84 €, buxheti për këtë periudhë është më i lart për 25.08% se buxheti i vitit 2022. Gjithsej pagesat kanë shënuar rritje prej 27.23% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ku kontributin më të madh në këtë rritje gjatë kësaj periudhe e ka dhënë kategoria e shpenzimeve kapitale dhe kategoria e pagave dhe mëditjeve. Shpenzimet për paga dhe mëditje gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, shënuan shpenzimin prej 7,407,538.93 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 99.88% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet në mallra dhe shërbime kanë shënuar një rritje prej 28.07% krahasuar me vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur në 1,716,950.69 €, kjo shumë korrespondon me 96.31% të buxhetit për këtë kategori. Shpenzimet në komunali, kanë shënuar rritje prej 40.85% krahasuar me vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur 235,175.78 €, kjo shumë korrespondon me 100% të buxhetit për këtë kategori. Shpenzimet në subvencione dhe transfere, shënuan shumën prej 420,962.85 € gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 87.55%. Shpenzimet kapitale. Shpenzimet kapitale arritën shumën prej 4,911,241.33 €, që është 86.88% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet kapitale gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 53.60%, apo rreth 1,713,872.99 € më shumë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Drejtori i Drejtorisë së FEZH e përmbylli fjalën e tij duke dhënë detaje për të hyrat vetanake, nga donatorët dhe të tjera dhe shpenzimet e buxhetit që janë bërë dhe natyrisht duke i krahasuar ato me vitin paraprak.

z. Kushtrim Haliti: Përsëritje. Raportin e kemi lexuar por sa kam mundur me e pa ky raporti nuk është i specifikuar mirë. Shuma e Buxhetit për vitin 2023 është 15 milion e 568 mijë e 206

euro dhe i shpenzuar është 94% që i bien 14 milion e 691 mijë e 869 euro. Shuma prej 5.7% nuk e kanë përfshi hiç e që është 876 mijë e 337 euro. Tek shërbimet, shpenzimet e udhëtimit brenda vitit në vitin 2022 janë 33 mijë e 134 euro ndërsa në vitin 2023 janë 53 mijë e 603 euro që i bien 20 mijë euro diferencë. Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë shtetit në vitin 2022 janë 150 euro ndërsa në vitin 2023 janë 9147 euro. Diferenca është 9000 euro. Shpenzimet e ndryshme shëndetësore nuk kam mundur që ta kuptoj, në vitin 2022 janë 46 mijë euro ndërsa në vitin 2023 janë 205 mijë euro, diferenca është 158 mijë euro.

Z. Haliti përmendi edhe shpenzimet e rritura për anëtarësim, furnizim me ushqim , pije jo dreka, sigurimin e ndërtesave të tjera, pastaj tek mbeturinat, pagesat për përfituesit individual që në vitin 2022 ishin zero ndërsa në 2023, 134 mijë e 150 euro. Z. Haliti përmendi edhe objektet kulturore dhe sportive për të cilat janë rritur shpenzimet etj.

Për fund Kushtrim Haliti tha se një buxhet i përpiluar në vetëm dy faqe pa e specifikuar se nga kanë shkuar mjetet e tatimpaguesve mendoj që nuk është i punuar mirë dhe është i papranueshëm.

z. Ndrec Zefaj: Përsëndetje të gjithëve. Dëshiroj të ndërlihem tek paraqitja e drejtorit të këtij raporti financiar. Tek të hyrat vetanake u tha se janë tejkaluar gjatë vitit 2023 por e pashë që 300 mijë euro janë të hyra nga gjobat e trafikut. Kjo nuk është meritë dhe përformncë e komunës. Dua të i përmend rritjen e shpenzimeve për udhëtimet brenda dhe jashtë vendit , shpenzimet e telefonisë, tek shpenzimet kapitale shihet që kemi një realizim të kënaqshëm dhe unë si asamblist i gëzohem kësaj shifre. Pasi jemi në fillim të këtij viti po shpresoj që ky buxhet do të jetë edhe më i lartë në kategorinë e kapitale dhe krahas rritjes të kemi edhe projekte më të shumta dhe më të mira të përfunduara.

z. Valmir Bacaj: Përsëndetje të gjithëve. Bazuar në këtë raport buxheti për këtë periudhë është më i lartë se sa i vitit paraprak për 25.08%. Sigurisht se krahas rritjes së buxhetit kemi edhe rritje të shpenzimeve e që janë 27.23% më të larta se sa viti paraprak. Në këtë rritje ndikimin më të madh e aknë shpenzimet kapitale që siç e dimë janë në favor të përmbushjes së nevojave të qytetarëve tanë. Gjithashtu edhe të hyrat vetanake vazhdojnë me trend pozitiv ku në vitin 2023 kishim rritje për 28.89%. Vetëm në tatimin në pronë kemi pagesa më shumë për 157 mijë euro. Ky është një tregues i çartë i vetëdijesimit të qytetarëve karshi përmbushjes së obligimeve që i aknë ndaj Komunës e kjo tërthorazi tregon edhe rritje të besimit të qytetarëve karshi qeverisjes së mirë dhe transparente.

z. Bacaj vazhdoj duke vë në pah shpenzimet e mira të buxhetit duke thënë se shumë komuna e kanë pasur sfidë që ta arrijnë këtë shifër të shpenzimit e kjo thotë ai është si arsye e planifikimit të mirë nga zyra e prokurimit dhe ekzekutivit. Ne si grup kuvendar e vlerësojmë pozitivisht këtë raport tha në fund z. Bacaj.

Znj. Besiana Gashi: Përsëndetje të nderuar. Unë po ndalem vetëm të disa shpenzime të cilat mund të merren në konsideratë me qellim të zvogëlimit siç janë ato të udhëtimit brenda vendi, pastaj mobileje më pak se 1000 euro ku shuma e shpenzuar këtë vit është stërzgatur, furnizim , ushqim pije jo dreka gjithashtu diferenca mes viteve është 64000 euro që janë dyfishi i viti të

kaluar. Furnizim me veshmbathje diferenca është afër 2000 euro. Drekat zyrtare gjithashtu ka shpenzime të rritura ku ekzekutivi duhet të bëjë përpjekje që të i zvogëlojnë në minimum.

z. Zafer Gashi: Është e vërtetë që ne e kemi përcjell çdo raportim 3 mujor dhe kjo është një përmbledhje e tërë vitit 2023. Shumat po shihen më çartë dhe them se është që të lavdërohen qytetarët për kryerjen e obligimeve kundrejt Komunës. Po ndalem pak tek shpenzimet, konkretisht tek shëndetësia e cila po e kalon 300 mijë euro.

Z. Zafer Gashi përmendi në detaje shpenzimet në shëndetësi dhe u ndal tek “shërbimet e tjera” dhe shpenzimet në këtë kategori ku tha se nuk po e din se cilat janë këto shpenzime të tjera. Sigurimi i ndërtesave të tjera, cilat janë këto ndërtesa të tjera? Tek 46 mirëmbajtja e ndërtesave afariste po bien në sy për herë të parë. Rregullimi i shtretërve të lumenjve nëse marrim shumën që janë harxhuar në këtë aspekt kalojnë shumë investive për ujin e pijshëm, tha z. Gashi. “Kualiteti i punëve le shumë për të dëshiruar, projektet në shumë raste edhe pse janë kryer nuk funksionojnë dhe mendoj që duhet të i kushtohet kujdes më të madh që të fitoni besimin e qytetarëve” e përfundoj fjalën e tij z. Zafer Gashi.

z. Enver Gashi: Përsëritje të gjithëve. Falënderoj drejtorin për këtë raport të detajuar financiar. Dua të ndalem tek krahasimet e shpenzimeve nga 2023 në 2022. Trendi i ulur i disa shpenzimeve na gëzon të gjithëve por kjo nuk do të thotë që është arritur maksimumi. Në disa kategori janë rritur shpenzimet që mos të i përmend të gjitha tani kërkoj në fund që ekzekutivi të i ulë këto shpenzime gjithsesi.

z. Tunë Dedaj: Përsëritje të gjithëve. Pajtohem me gjithë atë që tha z. Valmir Bacaj dhe dëshiroj që të falënderoj qytetarët e Klinës që janë bindur në këtë qeverisje të mirë dhe ju kanë përgjigj thirrjes së ekzekutivit që të i kryejnë obligimet e tyre. Ndërsa sa i përket shpenzimit të udhëtimit të nxënësve, Enver Gashi e din se ka qenë drejtor se ai është udhëtimi i nxënësve, autobusët që bartin nxënësit e më të cilët kemi kontratë. Çmimet janë rritur prandaj janë rritur edhe shpenzimet.

z. Kushtrim Haliti: Dëshiroj që të ndërlidhem me atë që tha z. Tunë Dedaj. Shtrenjtimi i biletave të autobusëve nuk është bërë në vitin 2023 por në vitin 2022. Të gjitha shtrenjtimet në fakt kanë ndodhur në vitin 2022 ndërsa në vitin 2023 kemi pasur ulje të çmimit të karburantit prandaj edhe shpenzimet në 2023 do të duhej të ishin më të vogla në këtë aspekt.

z. Tunë Dedaj: Faleminderit Kushtrim. Unë po të garantoj se çmimet janë rritur sepse janë rritur çmimet e tregut të përgjithshëm. Janë rritë pagesat e bartësve, janë rritur numri i nxënësve që barten me autobus.

z. Kushtrim Haliti: Jam në komision dhe e diji që në vitin 2023 nuk janë shtuar asnjë shkollë për bartjen e nxënësve.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Jam dakord të nderuar që të jepni vërejtjet e juaja dhe aty ku ka mundësi të përmirësohemi edhe ne por logjikisht në çdo vit buxhetor coftë kontrata të bartje të nxënësve ose kontrata të tjera janë më të larta, janë çmimet e tregut që diktojnë këtë. Po nisem me pyetjet që i bëri i nderuari Haliti për shpenzimet e udhëtimit brenda. Është bartja e nxënësve dhe përveç kësaj është shpenzim shtesë e bartjes së nxënësve nëpër r gara nder komunale.

Shpenzimet jashtë vendit: ne të gjithë kemi qenë në Turqi dhe s' di pse po e bëni këtë pyetje se dihet. Shpenzimet e tjera jashtë vendit janë shpenzimet e zyrtarëve që bëjnë trajnime të ndryshme jashtë vendi por është edhe vizita e jonë me kryetarin në Itali me ftesë zyrtare. Pjesa e pajisjeve me mobileje janë pjesa më e madhe në shkolla ku janë pajisur me banka etj. Furnizim me ushqim dhe pije jo dreka, janë shpenzimet e fund vitit që edhe ju i keni marr ato por edhe shpenzimet ushqimore për çerdhe.

Drejtori Berisha në vazhdim tregoj se një pjesë e mjeteve ka mbetur nga një kod i vjetër dhe ka hyrë në një kod të ri. Ai po ashtu shpjegoj edhe për shpenzimet në shëndetësi, shpenzimet e veshmbathjeve për zjarfikës etj., mirëmbajtja e pajisjeve dhe mobileve tha se të gjitha këto pajisje që i kemi duhet të servisohej dhe mirëmbahen. Dreka zyrtare, kësaj radhe kemi një vizitë të presidentes në Klinë që ka kushtuar tek 1000 euro, tha drejtori i FEZH, z. Berisha. “Shpenzimet në mbeturina janë bartje të borgjeve nga 2022 në 2023 rreth 20 mijë euro, ndërsa sigurimi i ndërtesave është ajo pagesa për punëtorët e sigurimit fizik në shëndetësi”, e përfundoj z. Berisha.

z. Kushtrim Haliti: Prej 13 pyetjeve që bëra , 4 nuk i morra. Dy po shpresoj që do ti marr nga drejtoresha e Kulturës por janë disa që nëse ke mundësi drejtor: 1. Pagesat për përfituesit individual , 2. Pajisje të tjera, 3. Pagesat e vendimeve gjyqësore.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Pagesat individuale janë subvencionet që epen për të sëmurët etj. Pajisje të tjera janë shpenzimet e nxehjes qendrore në “Fehmi Agani”, shkollën fillore dhe në shkollën e mesme të ulët në Siqevë me pompa termike kuptohet. Tek vendimet gjyqësore janë dy përmbarime.

Znj. Fatjona Gashi, drejtoreshë e DKRS: Përsëritje të gjithëve. Sa i përket pyetjes për shpenzimet për shërbimet kulturore rreth 63 mijë euro. Kushtrim, as palestra as qendra nuk janë objekte që duhet të krenohemi me to sepse kanë mangësi të mëdha por falë komunitetit artistik dhe sportiv mbahen aktivitete në këto objekte. Kam provuar që të rinovohen, rreth 20 mijë euro janë investuar në palestër në kulmin që pikonte, inventar brenda saj etj. Shumë prej 63 mijë euro-vetëm 3500 euro janë futur tek kulla e Mujë Krasniqit ndërsa pjesa tjetër i p[ërket investimeve urbane që janë rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave.

Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës për vitin 2023.

z. Esat Raci: Për këtë pikë të rendit të ditës ne si grup kuvendar të PDK-së nuk do të marrim pjesë sepse materialin e kemi marrë dje në orën 10 dhe mendoj se nuk është përgjegjësi e stafit por përgjegjësi e ekzekutivit. Sa i përket këtij raporti, qytetarët janë të bindur se ky ekzekutiv për 2023 do të mbahet mend vetëm për punësimet e familjarëve dhe grupeve të interesit të partisë në pushtet. Uroj që ky avaz të mos vazhdoj më tutje. Kohëve të fundit jemi dëshmitar të një gjahu për stafin civil në emër të disiplinës ku po bëhet dallime tek shërbyesit civil nuk do të donin që kjo q qeveri të jetë për dike nënë e për dike njerjë.

Grupi Kuvendar i PDK-së e lëshon mbledhjen.

z. Zafer Gashi: Më vjen mirë prej PDK-së që më në fund ka nisur të kuaj rolin e opozitës. Shpresoj që edhe LDK me kryetarin e ri të nisë me veprime demokratike. Falënderoj gjithashtu atë që e ka punuar këtë raport sepse kish vendosë foto të bukura dhe dizajn të mirë.

z. Zafer Gashi kishte vërejtje te fjala e kryetarit që e nisë këtë raport. Do të duhej të ishte një foto me kryeministrin Kurti sepse edhe Kryeministri ka ndihmuar edhe qeveria në investimet për ujin e pijshëm dhe jo vetëm komuna. Nëse është ndryshe do të doja ta dija sepse unë skam qenë fare dakord që të kryhet ajo vizitë dhe ai investim sepse epo investohet në puse ku nuk ecë uji.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje për të gjithë. Po përgjigjem direkt. Qeveria nuk ka ndihmuar me asnjë cent, vlera prej 200 mijë euro është nga performanca e Komunës, është vlerë e punës së Ekzekutivit dhe kuvendit. Nuk ka asnjë cent të ndarë nga asnjë ministri. Donator të kësaj performace janë qeveria dhe “Demos” por është garë dhe nëse nuk e meritojmë nuk do ta merrnim.

z. Zafer Gashi: Në garën e performancës kemi ndihmuar edhe ne si asamble. Keni amrr para nga qeveria përmes grandit të performancës gjithsesi.

z. Vamir Bacaj: PDK doli e lëshoj seancën , po ne e kemi pranuar raportin dhe para orës 10 dhe mendoj që janë të mjaftueshme për 24 që të lexohet.

z. Fadil Gashi, kryesues: Këtu kemi një vërejtje simpatike sepse materiali duhet të shkoj tek anëtarët para, 7 ditë pune. Herë të tjera është mirë që materiali të ju shkoj me kohë anëtarëve të Kuvendit.

Vazhdon më tej z, Valmir Bacaj duke thënë se kot po mundohet me e nxjerr mirë qeverinë z. Zafer Gashi sepse qeveria nuk e diji as pse ka marr pjesë në atë përrurim sepse s` ka dhënë asnjë cent e po ashtu as në buxhetin e vitit 2024 asnjë cent nuk e ka nda për komunën e Klinës. Mos harroni se qytetarët e Komunës në zgjedhjet e fundit të përgjithshme LVV ja kanë dhënë mbi 5000 vota.

z. Valmir Bacaj për raportin e punës së Ekzekutivit për vitin 2023 kishte fjalë miradije dhe tha se ky raport përveç të arriturave të pasqyruara paraqet edhe sfidat edhe vështirësitë. “Gjithsesi kritikën me vend do ta ndihmojnë qeverinë lokale që të punoj akoma më mirë por vlerësimin më të mirë e japin qytetarët”, tha në fund z. Bacaj duke inkurajuar kryetarin e komunës për vazhdimin e tillë të punës .

z. Arben Limanaj: Shqetësimi i grupit të PDK-së ishte me vend. Vërejtja e parë për këtë raport është se në faqen e parë të këtij raporti vendose fotografia e liderit të partisë që për mua nuk është aspak e hijshme. Kjo foto tregon shumëçka, që e keni politizuar procesin e rekrutimit të stafit shërbyes. Janë favorizuar anëtarët e partisë në pushtet edhe sa i përket ndërtimit të infrastrukturës, ndarjen e subvencioneve. Flet vet edhe foto e liderit tuaj që për mua nuk do të ishte e drejt të vendoset në një raport të punës së një ekzekutivi.

Z. Zenun Elezaj, kryetar: Raporti ka shkuar të premtën në zyrën e kuvendit por zyra në fjalë ka pritur që të kompletohet edhe me material tjetër. Sa i përket fotografisë së kryetarit të

Aleancës, ai është deputet i Kuvendit të Kosovës, unë çdo deputet e pres me kënaqësi dhe çdo lider politik që ka numër të madh njerëzish pas vetes.

z. Valmir Bacaj: Kryetari Haradinaj në këtë fotografi ka dalë kur ka qenë në përurimin e shtatores së një bashkëluftëtari të tij në Grabanicë, Sadri Berisha.

Me 14 vota për, 4 vota abstenim dhe asnjë kundër U MIRATUA raporti i punës.

Pika e 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës së KKSB

Znj. Marqe Selmanaj, nënkryetare e Komunës: Përshëndetje të gjithëve të pranishëm. Gjatë kësaj periudhe raportuese, parimi kryesor i KKSB-së ka qenë përqendrimi kryesisht në aktivitete për çështje të sigurisë, duke bashkëpunuar me policinë, qytetarët, forumet, organizatat e sigurisë, KLSP-të dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Synimi ka qenë identifikimi dhe shqyrtimi i çështjeve lidhur me problemet e sigurisë në bashkësi, me qëllim zgjidhjen konkrete të këtyre sfidave. KKSB-ja ka pasuar synimin identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike, parandalimin e veprimeve që kërcënojnë sigurinë në bashkësi, eliminimin e dukurive të lidhura me natyrën e krimit, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme. Gjithashtu, ka qenë e përkushtuar për krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në territorin e komunës së Klinë

Nënkryetarja e komunës së Klinës, znj. Marqe Selmanaj, tha se ka drejtuar takimet e Këshillit Komunal për Sigurinë në Bashkësi (KKSB), ku shqyrtohej plani i veprimit për vitin 2023, dinamika e punës, siguria në komunë, çështjet e arsimit, pajisjet me kamera në shkolla, mbrojtja nga zjarret, ndriçimi publik, qentë endacakë, dhe masa parandaluese për mjete piroteknike gjatë festave. Komandanti i policisë raportonte për sigurinë, ndërsa ka pasur bashkëpunim të lartë me komunën, KKSB-në, dhe komunitetet. Në diskutime janë përfshi anëtarë të KKSB-së, Këshilli i prindërve, OJQ-të, si dhe përfaqësues nga OSB-ja, KFOR-i, FSK-ja. Të gjitha çështjet u shqyrtuan nga përfaqësues kompetent të organeve komunale. Të gjitha kërkesat, vërejtjet, sugjerimet dhe ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit e KKSB-së, janë diskutuar, shqyrtuar nga përfaqësues kompetent të organeve komunale.

Sa i përket rezultateve të arritura nga takimet e KKSB-së për vitin raportues 2023 znj. Marqe Selmanaj tha se Institucionet komunale, gjegjësisht drejtoritë përkatëse, kanë arritur të realizojnë projektet që ishin në lidhje me Planin e KKSB-së si, ndriçimin në shumë rrugë dhe lagje të planifikuara aty ku kanë munguar. Në disa pjesë të qytetit, drejtoria përkatëse ka ndërmarrë masa për rregullimin e ndriçimit në zonat me probleme të theksuara edhe aty ku paraqite rreziku për qytetarët.

“Gjatë vitit 2023 janë mbajtur të gjitha takimet e rregullta të KKSB-së, takimi i fundit mbahet më 19.12.2023. Materialet për takime janë dorëzuar me kohë anëtarëve dhe pjesëmarrësve të ftuar”, tha në fund të fjalës së saj, znj Selmanaj.

Me 19 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 7 e Rendit të Ditës: Propozim I zëvendësimit të anëtarit të KKSB Marko Nedelkovic me propozimin për zëvendësim nga Natasa Gasic.

Me 18 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 8 e Rendit të Ditë: rishqyrtim I akteve të miratuara të Kuvendit Komunal, kërkuar nga MAPL

Kryesuesi shpjegoi se bëhet fjalë për vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të përbashkët në lagjen BALAJ në fshatin Sferkë. Dhe ja dha fjalën drejtorit të urbanizmit.

z. Enver Berisha drejtor I Urbanizmit: Përsëritje të gjithëve. Sa I përket kësaj lënde, ne e dimë që është një zonë rekreative e cila në përshkrimin e saj thotë se mund të ketë edhe shërbime sociale. Ne drejtori e urbanizmit kemi menduar se shërbim social mund të jetë edhe ajo shtëpi e fshatit, lagjes. Nuk e kuptoj qysh e kanë kthyer për rishqyrtim dhe pse nuk mund të lejohet të ndërtohet një objekt që është në shërbim të qytetarëve.

z. Fadil Gashi, kryesues: Për këtë rast jemi bazuar në një vendim të njëjtë që ka nxjerr Komuna e Malishevës dhe atyre nuk jua ka kthye ministria për rishqyrtim , megjithëkëtë ne duhet të procedojmë ashtu siç kanë kërkuar nga Ministria.

z. Tunë Dedaj: Unë mendoj që të mos e anulojmë por të pajiset me leje ndërtimi dhe të ndërtohet ai objekt sepse ata nga ministria as që kanë dalë në teren dhe as nuk i dinë hallet e qytetarëve.

z. Enver Berisha, drejtor I Urbanizmit: Ne jemi bazuar kryekëput tek përshkrimi I hapësirës që thotë se mund të jetë për shërbime sociale.

z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës: Ne për arsye të performancës është mirë që ta anulojmë vendimin dhe më pastaj drejtorja e urbanizmit të shkoj në takim me nivelet e caktuara në MAPL apo në ministritë e tjera dhe të konsultohet për të gjetur një zgjidhje.

Me 17 vota për , një kundër dhe 4 abstenime U MIRATUA

Vendimi tjetër I kërkuar për rishqyrtim është Strategjia zhvillimore ekonomike lokale. Nga ministria ju aknë referuar disa pjesëve që duhet ndryshuar dhe ekzekutivi e ka harmonizuar këtë strategji sipas kërkesave të tyre. Ju e keni para vetës me ndryshime.

z. Valmir Bacaj: Shkresën e dytë nuk e kemi pranuar me material, shkresën e ministrisë por pasi që janë rishikuar ajo që është kërkuar ne jemi për.

Me 21 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim , me ndryshimet e kërkuara nga ministritë U MIRATUA Strategjia zhvillimore lokale.

Pika 9 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje.

z. Kushtrim Haliti: Kam pyetje për kryetarin. Dëshiroj të di që se a kanë me u krye disa rrugica në lagjen “Bullaku” në Jashanicën e epërme, rruga e lagjes Selmani dhe kanalizimi që nuk ju ka shkuar afër 500 metra larg si dhe në Gjurgjevik të Madh tek familja e Fatmir Berishës dhe lagjes “Raci”, rruga që nuk ju ka shtruar dhe e dyta shumë në gjendje të keqe. Këto I ke pas premtuar por me siguri s` ke arritur që të i përfshini në realizim.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Në Gjurgjevik të Madh kemi dalë dhe kemi shikuar të gjitha rrugët dhe të gjitha ato të mbetura pa shtruar me asfalt do të shtrohen. Edhe pjesa e kanalizimit gjithashtu. Në Jashanicë është projekt dy vjeçar dhe të gjitha ato rrugica do të kryhen. E kam vizituar edhe lagjen Selmanaj në Shtupel ku edhe aty do të përfundojnë gjithqysh.

Znj. Besiana Gashi: Kam një pyetje për drejtorin e bujqësisë. Në cilën fazë është shpallja publike në bashkëpunim me organizatën IRK për sera dhe multikultivator pasi që afati I fundit për aplikim ka qenë data 14 nëntor e vitit 2023.

z. Lorenc Marleku, drejtor i bujqësisë: Po keni të drejtë, ajo është në fazën përfundimtare dhe Brenda një apo dy ditëve do ta bëjmë shpalljen.

z. Ndrec Zefaj: Kam një pyetje për kryetarin e komunës, në lidhje me ndërprerjen e energjisë elektrike në Zllakuqan dhe për rreth. Këto ndërprerje janë si pasojë e rrjetit të vjetër elektrik. Kur do të bëhet zëvendësimi i këtij rrjeti, a keni informata nga KEDS për këtë problematikë.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Po, në të vërtetë nuk kemi kompetenca në këtë çështje, është e KEDS por ne kemi bashkëpunim të mirë dhe unë në takim me ta në shkurt do të kërkojmë që të zëvendësohet ky rrjet I vjetruar. Jo gjithçka edhe KEDS mund të investoj pa miratimin e rregullatorit të energjisë.

z. Arben Limanaj: Gjatë seancës një qytetar më pyeti për mjetet që i kanë dhënë mërgimtarët për pasojat e vërshimeve.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Ato mjete nuk janë shpenzuar dhe vlera është diku tek 31 mijë euro. Ato mjete do të bartën dhe kemi në plan që në një të ardhme të shkurt me ato mjete të tubuara dhe shtesa nga subvencionet të kompensohen disa qytetarë për dëmet e krijuara nga vërshimet.

z. Zafer Gashi: Qe 6 muaj ditë jam në komitetit për Arsim por askush nuk më ka ftuar deri tani për ndonjë mbledhje. Pyetja tjetër: Me datën 22 është folur dhe qytetarët janë të interesuar të dinë për pohimet e juaj kryetar, dhe drejtorit Berisha se çështja e fabrikës së çimentos është kthyer në zero. Unë kam shkuar në zyrën e z. Berisha dhe e kam marrë atë vendim. Nuk duhet të dezinformohet opinion se gjoja ky është një vendim që e obligon komunë se duhet me prit. Shtrohet pyetja se nga i erdhi ky dokument kryetarit dhe drejtorit. Ky dokument vendim ju ka ardhur nga pala e tretë. Unë tani po ju them se me 4 dhjetor të vitit 2023 përsëri gjykata themelore e ka marrë të njëjtin vendim si në herën e parë, para së të kthehej në zero. Vendimi i asamblesë komunale e ka fituar gjyqin dhe ne duhet ta detyrojmë kryetarin e komunës që ta tërheq lejen e ndërtimit të kësaj fabrike.

z. Fadil Gashi, kryesues: Seancën e kaluar e keni marrë një informacion nga unë bazuar në informacionin zyrtar të drejtorisë së urbanizmit, jua kam konfirmuar atëherë bazuar në këtë por jo se kam parë vendim fizik. Tani kjo që ju e thoni se edhe vendimi i dytë është nxjerr nga gjykata por deri ta kemi një vendim të formës së prerë, vendimi i kuvendit është legal. Vetëm një organ i gjykatës, jo i ministrisë sepse ministria nuk mund të thyej asnjë vendim të kuvendit por kërkon rishqyrtim, mund të na anuloi vendimin tonë të kuvendit. Tani paska ardhur edhe vendimi I dytë , nëse e din drejtori është mirë me na informuar sepse janë akte që nëse nuk respektohen

kanë pasoja të mëdha juridike. Vendimet e gjykatave ne as nuk I shqyrtojmë as nuk I diskutojmë sepse nuk kemi mandate.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Vendimi është në websajtin e gjykatave. Tani për këtë vendimin e ri po e ditke ti. Në rregull është, në fund të fundit vendimi I vjen drejtorit dhe jo mua por ne gjithsesi duhet të presim procedurat e apelimit etj. Shpresoj që të gjitha vendimet gjykatat do të I marrin kështu shpejt pasi që në këtë rast kanë vepruar shumë shpejt por ne duhet të presim vendimin e formës së prerë. Deri atëherë asnjë rrezik nuk ka për të nisur ndërtimet e fabrikës sepse leja për ndërtim është pezulluar nga Komuna.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit: vendimi i parë për kthim në piken zero mua me ka ardhur në emalin zyrtar dhe është kërkuar që mos të veprojmë. Unë respektoj vendimet e gjykatave. Unë mendoj që kjo është një çështje e pezulluar dhe po presim vendimet e gjykatës së di pse po e bëni temë në çdo seancë.

Tutje debate rreth kësaj çështje vazhdoj edhe më tej në mes të z. Zafer Gashi, Kryetarit të Komunës, drejtorit Berisha por kryesuesi kërkoj që të kthehemi tek pika e rendit të ditës.

Z. Zafer Gashi tha se ka pasur kërkesë për qasje në dokumentet publike dhe falënderoj shumë për shpejtësinë e kthimit të përgjigjes, znj, Tafilaj. Më ka interesuar kontrata e nënshkruar nga z. Elezaj, z. Morina dhe një personi tjetër. Është kontrata që ka të bëjë me shërbimin shëndetësor, kujdesin paliativ (është term në mjekësi që edhe mund të jetë shkruar gabim nga procesmbajtësi). Dëshiroj të pyes kryetarin se a jeni duke e përcjell këtë kontratë, pasi që ju e keni edhe menaxher atë aktivistin e juaj, a është duke u zhvilluar sipas rregullave të përcaktuara në kontratë ku shkruan se operatori duhet të ofroj stafin mjekësor, automjetet, pajisjet e nevojshme për projektin. Sa kam informacion unë nuk aknë shkuar siç duhet kjo punë. Kam informacion që operatori ekonomik është duke shfrytëzuar asetet e komunë për ta realizuar këtë kontratë dhe është gjobitur operatori në fjalë.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Si në çdo projekt që caktohet menaxheri i kontratës edhe në këtë projekt, menaxher projekti është Agron Bacaj që është drejtor i shëndetësisë dhe menaxher i kontratës është Driton Berisha. Për më shumë specifika është drejtori që na shpjegon.

z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë: z. Zafer bëhet fjalë për një kontratë që ofron shërbime shëndetësore për njerëzit e palëvizshëm,. Këtë kontratë e ka fituar operatori që ka pasur çmimin më të lirë. Një herë e ka fituar Caritas pastaj në 2017 e njëjta kompani që është tani. Ju e dini ne ballafaqohemi me kërkesa të shumta për numrin e stafit shëndetësor por e kemi të limituar këtë mundësi prandaj komunat janë obliguar që të gjejnë mundësi të tjera. Përmes këtij projekti janë të punësuar punëtor që marrin paga dhe kryejnë shërbimin e nevojshëm. Të gjitha shërbimet për këtë kategori bëhen me mjetet dhe shpenzimet e operatorit. Inspektorati shëndetësor e ka dhënë një gjobë ndaj këtij operatori por siç keni lexuar në media operatori ekonomik në fjalë e ka fituar kontestin në gjykatë.

z. Valmir Bacaj: Unë nuk kam pyetje por kam një vërejtje sepse te kjo pikë e rendit të ditës po tejkalohet minutazha e përcaktuar. I llogarita minutat dhe vetëm Zafer Gashi i ka marrë mbi 20 minuta në këtë pikë. I kisha sugjeruar Zaferit që të i lexoj ligjet për vetëqeverisje lokale dhe

rregulloren e punës së kuvendit. Po ashtu kërkoj që të jetë më i kujdesshëm kur të drejtohet personalisht sepse the sikur mua s` po më konvenon kur përmendet fabrika e çimentos. Ndoshta ti nuk e ke problem që të shkosh nëpër gjykata por çdo fjalë këtu që flitet mund të përdoret në gjykatë. Vendimet e gjykatave I ke të gjitha nëpër web të ministrive edhe përbërjen e komiteti që nuk e dijë kush janë dhe në këtë mënyrë na e kursen Kohen.

z. Zafer Gashi: 8 minuta e 15 sekonda ka folur Valmiri veç tani. Sa kohë marrë këtu unë flas për qytetarët dhe jo për partinë time. Nuk marr asnjë leje nga personi në fjalë se sa me folë. Kjo që po provon me e shurdhu zërin e opozitës nuk është hera e parë si dëshirë e tij. Por, ka kaluar koha kur ka marrë vota Valmir Bacaj sepse e ka dikë të punësuar në entin social edhe ja bënë votat, s` ka më ashtu. Duhet me dalë me i marrë vet votat tash e mbrapa.

z. Valmir Bacaj: Sa i përket votave, Zafer, shikoj ato panot radhë në muri. Prej vitit 2000 ne si familje kemi nga një përfaqësues aty. Votat i kam marrë kur kam qenë opozitë dhe kam qenë anëtar i kuvendit. Agron Bacaj katër mandate ka qenë anëtar i Kuvendit si opozitar. Sa i përket QPS sepse e diji që aty aludon, anëtari i ynë i familjes është punësuar në vitin 2006, vëllai im ka punuar në shërbimet sociale dhe jo në asistencë sociale. Nëse nuk e din shko merr informata se çfarë shërbimesh kryhen aty dhe mos manipulohet. Ti se e ke mandatin e parë këtu dhe s`ke arrit me marr as 200 votat me premtimet e tua për dhënie të bursave dhe kur nuk po jua jep pastaj bursat po të I dërgojnë lëndët në polici njerëzit, ajo është temë e jotja por ti kanë publikuar në rrejte sociale njerëzit këto gjera. Kush gënjen dhe kush manipulon, qytetarët e Klinës na njohin të dyve.

z. Tunë Dedaj: Në emër të qytetarëve dua ta falënderoj drejtorin e shëndetësisë për punët e mira që është duke i bërë.....

Këtu pati shkëmbim fjalësh në mes të z. Zafer Gashit dhe z. Valmir Bacajt dhe në një moment edhe të drejtorit z. Agron Bacaj, duke ja ndërprerë fjalën z. Dedaj. Kryesuesi kërkoj që të përmbahen. E tërë replika dhe kundër replika mes të përmendurve është bërë pa mikrofon të hapur dhe s` ka të bëjë me pikën e rendit të ditës.

z. Kushtrim Haliti: Kam dy pyetje për drejtorin e Urbanizimit. A është bërë pranimi teknik për rrugët “Arben Haliti” dhe rrugën e gjimnazit. Dëmet që i janë bërë lokaleve , është i madh dhe pronaret e lokaleve janë detyruar që të bëjnë vet rregullimet. E ka rregulluar vetëm rrugën operatori por nuk e ka kthyer në gjendjen e mëparshme pjesën tjetër. Po ashtu kur është bërë prezantimi i projektit të rrugës së gjimnazit aknë qenë të parapara edhe disa parkingje por që tani pasi është realizuar projekti nuk ka asnjë parking në atë rrugë.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizimit: Realizimi i projektit është pranuar teknikisht edhe faza e parë edhe e dyta. Sa i përket rrugës “Ymer Berisha” Është projekt I mirë dhe ka afat deri në muajin tetor 2024 gjë që ne nuk mund ta detyrojmë operatorin që të punoj jashtë planeve të menagjimit. Sa i përket punimeve ajo shikohet kur të përfundon dhe para se të pranohet teknikisht.

Znj. Arta Pantina: Edhe unë kam pyetje për drejtorin e urbanizmit. Kam kërkuar që të bëhet pastrimi i dy rrugëve në fshatin Gllarevë nga barishtet, therrat etj. që nxënësit të mos kalojnë rrugës por pjesëve anësore që janë të parapara.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit: Këtë pyetje duhet të ja shtrosh Shërbimeve sepse ajo është për mirëmbajtje. Nëse është projekt që ka afat kohor dhe sigurim atëherë ne mund të ju përgjigjemi.

Këtu e përfundoj seancën e kuvendit kryesuesi duke falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe kontribut.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryesuesi:

Fadil Gashi



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Komuna e Klinës

Zyra e kryetarit

Klinë, 26. 12. 2023

PROCESVERBAL

Nga takimi i dytë i kryetarit të Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj me qytetarët e Komunës së Klinës, mbajtur me datë 26. 12. 2023 në sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 10:00

Kryetari z. Elezaj falënderoj qytetarët për pjesëmarrës në këtë takim të dytë për vitin 2023 .

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje për të gjithë. Fillimisht po mundona që në pika të shkurta të jap një përshkrim të udhëtimit që kemi bërë në këtë pjesë. Pjesa më e rëndësishme ka qenë realizimi i projekteve dhe shfrytëzimi i buxhetit konform Buxhetit të aprovuar me vendimin e Kuvendit dhe vendimit të qeverisë së Republikës së Kosovës. Që në fillim të vitit buxhetor fillon mobilizimi për përgatitjen e para masave dhe para llogarive dhe fillimin e procedurave të prokurimit për lidhjen e kontratave të obligueshme për realizimin e projekteve. Kemi një raport të ditës së sotme të aspektit financiar që mund të plotësohet nga pagesat që bëhen sot dhe që përkushtimi i të gjithë neve është at shfrytëzohet sa më shumë buxhetin konform realizimit të projekteve të planifikuara. Buxheti i aprovuar për kategorinë ekonomike- paga dhe mëditje ka qenë totali 6 milion e 753 mijë e 688 euro. Ky buxhet është realizuar 100%. Kategoria ekonomike Shpenzime kapitale janë 5 milion e 652 mijë euro , 78.4 % është shfrytëzuar, pra është arritur minimumi që kërkohet për kriterin e performancës. Kategoria ekonomike, mallra dhe shërbime, 94.34 %, Subvencione dhe transfere 92.82%, shpenzime komunale 100%. Në total buxheti për vitin 2023 ka qenë 14 milion e 878 mijë e 713 euro dhe është shfrytëzuar deri me tani 13 milion e 548 mijë e 917 euro ose 91.06%. Në pika të shkurtra këto ishin të dhënat e realizimit të buxhetit. Realisht ky vit ka qenë pak i ngarkuar tek kategoria e të hyrave vetanake që një vlerë prej 1 milion e 300 mijë eurove është bërë me vonesë, qeveria deri vonë nuk na i ka bartë ato mjete.

“ Të gjitha projektet kanë ecur në rrugë të mirë me përjashtim të disa projekteve që janë më të mëdha siç është fundërruesi i ujit të pijshëm për të cilin tre herë kemi pasur procedura por më në fund kemi arritur të nënshkruajmë kontratën. Po ashtu edhe impianti i ujërave të zeza në

Gllarevë ku kontrata është lidhur në kohën e fundit pasi që kemi pasur problem për të gjetur pronën ku të ndërtohet. Projekt tjetër është Shtëpia për të moshuar të cilin e kemi nisur me vonesë pasi që konfirmimi i ligjshmërisë për hapësirën na është kthyer për rishqyrtim. Këto mbase ndikojnë në % që është 78%, Përkushtim i yni në vazhdim ka qenë edhe në drejtim të ruajtjes së energjisë elektrike ku kemi zëvendësuar në disa shkolla, Komunë, QKMF ngrohjet me lëndë djegëse me ato termike. Projekte tjera që janë sfidë për ne janë projektet që i kemi në bashkëpunim me qeverinë siç është ai i rrugës transit. Dollci dhe Dresniku janë në të njëjtën trase ku do të kaloj transiti prandaj ne nuk po mund të bëjmë investime tani e të prishet kur të vije transiti sepse do të ishte keq menaxhim i parasë publike. Me infrastrukturë jemi mirë në të gjitha fshatrat. Kemi aplikuar për grande tek Komisioni evropian me pesë projekte të mëdha përmes ministrisë së zhvillimit rajonal. Janë projekte që ndërlidhen me rregullimin e shtratit të lumenjve dhe projekte të tjera që kapin vlerën milionëshe.” Përfundoj fjalën e tij kryetari i Komunës së Klinës duke ju dhënë mundësinë e fjalës qytetarëve të pranishëm në takim.

z. Marjan Ndrecaj, avokat: Ju dëshiroj suksese në vitin në vijim. Gjërat që kanë shkuar mbrapsht me dekada është vështirë me i kthyer në normalitet. Shpresoj që në mandatin e ardhshëm keni me pas sukses.

z. Xajë Raci: Përshëndetje. Shifrat që i prezantuat nuk i kam analizuar prandaj po i marr si të sakta. Problemet që janë trashëguar ose që i kemi duhet të i evitojmë. Kam marr pjesë në debate publike dhe gjithmonë i kam kritikuar për ujin e pijshëm. Edhe nëse uji sigurohet, Klina nuk mundet me i thënë qytetarit se i ka siguruar ujë kualitet të pijshëm sepse i ka akoma gypat e asbestit. Nëse uji që vjen nga pusi i Jerinës dhe bëhet bashkë në Tikvesh, vjen i turbullt. Kjo tregon që uji nuk është i mirë. Për të gjitha punët që kanë krye a nuk janë krye, fajin nuk e ka vetëm Pozita por edhe Opozita që nuk ju përcjell juve dhe punët jo të mira që po kryhen. Shembull rrugën “Hasan Prishtina” është shtruar një asfalt para dy viteve shumë i dobët, tani është shtruar dhe bërë një kahesh që nuk e përballon qarkullimin. Pastaj unë dalë dhe eci nëpër trotuare, trotuare që janë shtruar shumë keq. Bregut të lumit, prej Urës tek fusha e dukagjinit e tutje, janë trotuaret që aknë pjerrtësi të madhe dhe kanë nisur me fjete kubëzat të gjitha. Nuk e diji a kanë dalë inxhinierët në teren, ai është keqpërdorim i parasë publike. Dritat që i keni vendosur bregut të lumit, ju përgëzoj që i keni vendosë të tilla por nëse shohim nga Ura në qytet e deri të ura e fushës së sportit i aknë vendosur ato drita shumë keq. Shtrati i lumit, kubëzat janë vendosur sikur të ndërtohet shtëpinë e pastaj themelin. Asnjëri nga ne nuk i vendosim kubëzat në atë mënyrë. Kërkoj që të merret në përgjegjësi ose të futet në listën e zezë ajo kompani që nuk e kryen punën që duhet e po ashtu inxhinierët që nuk i shohin këto gjera ose janë të padijshëm ose të korruptuar.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Faleminderit Xajë. Inxhinierët janë këtu dhe besoj aknë marr shënime. Disa punime nuk janë pranuar teknikisht. Nëse flasim për trotuaret, deri tek ura e qytetit, ju them me përgjegjësi të plotë që kompania s’ka pasur çka bëjë sepse duke u ndërtuar ai trotuar kamionët janë parkuar aty. Ka pa dëgjueshmëri në këtë aspekt për këtë kam kërkuar edhe nga policia. Edhe unë i kam vërejtjet e mija por kemi pasur shumë telashe sepse kërkesat e

qytetarëve aknë qenë nga më të ndryshmet. Tek lagja “Dukagjini” nuk është pranuar trotuari akoma teknikisht, e ka për obligim kompania që ta bëjë rregullimin e tij para se të pranohet. Furnizimi me ujë, kemi kërkuar evidencë nga kompania “Hidrodrini” që të na tregoj se ku janë pozicionuar gypat e asbestit që të bëjmë ndërrimin e tyre. Tek Fabrika e ujit, fundërruesi do të bëjë pastrimin e ujit në 99% dhe besoj që do të kemi 100L/s dhe nuk do të ketë përzierje nga Pusi i Jarinës. Nga mesi i verës po shpresojmë që do ta vejme në funksion. Te Rruga “Hasan Prishtina” po shpresoj që do të lirohet kur të ndërtohet rruga transitit.

z. Xajë Raci: E thatë që kanë kaluar kamion nëpër trotuar dhe janë parkuar, ju siguroj që s` ka kaluar asnjë kamion andej por kubëzat kanë fjetur.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Jam çdo ditë nëpër Klinë dhe i shoh të gjitha rrugët dhe trotualet që po ndërtohen. Janë parkuar kamionë dhe mjete të rënda gjithsesi i kam parë vet. Sidoqoftë këto shqetësime tuajat do ti mbajmë shënim dhe do ti shikojmë.

z. Refki Krasniqi: Përshëndetje. Nuk po ndalem për punët që janë kryer. Ju e përmendet ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza. A ekziston teknikisht që ky projekt të ndahet në faza d.m.th. të fillohet me diçka e pastaj të vazhdohet tutje që mos të pritët grumbullimi i 10 milion sa kërkon ky projekt.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Konfiguracioni i Komunës së Klinës nuk e mundëson që të gjitha ujërat e zeza të grumbullohen në një lokacion të vetëm. Por sipas një studimi të fizibiliteti të hartuar në vitin 2019 është projektuar që në Jug të qytetit të ndërtohet një impiant që merr të gjitha ujërat e qytetit dhe të i trajtoj. Impianti kushton por kushtojnë edhe tubacionet e reja që përmes tyre me rënie të lirë vijnë në impiant. Jemi në fazat e integrimeve evropiane prandaj që tani duhet të fillojmë të i trajtojmë këto çështje mjedisore. Problem është që të futemi me buxhet komunal sepse ai është i vogël prandaj pa mbështetjen e qeverisë dhe donatorëve është i pamundur. Ne çdo vit ndërtojmë impiante me forca vetanake. Kemi ndërtuar në Volljak, në Sferkë dhe tani po e ndërtojmë në Gllarevë. Gjatë këtij viti kemi bërë shkresa që qeveria të na jep mundësinë e shfrytëzimit të tokës në Radulloc që të ndërtojmë edhe atje një impiant.

Pasi nuk kishte të tjerë të interesuar që ta marrin fjalën, kryetari i Komunës falënderoj të gjithë për pjesëmarrje dhe kontribut. Ai duke ju uruar festat e fund vitit mbylli takimin e dytë me qytetarë për vitin 2023.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryetari:

Zenun Elezaj



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 060-4722 /24

Klinë: 13.02.2024

PËR: Kuvendin e Komunës Klinë

Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa

Kryesuesi i Komitetit: Fadil Gashi



REKOMANDIMET e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës: 13.02.2024

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e II-të për vitin 2024, shqyrtoj dhe miratoj për shqyrtim në Kuvend këto pika:

Pika 1. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartje të mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2023,

-Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës referoj drejtori i drejtorisë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim Z. Enver Berisha i cili theksoj se të hyrat vetanake të vitit 2023 të cilat do të barten në vitin 2024 janë në shumën prej **942,121.66 €**. Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave Ligjit të buxhetit për vitin 2024 dhe Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nga teprica e mjeteve nga viti paraprak që barten në vitin vijues paguhen obligimet nga viti paraprak sipas kontratave të nënshkruara. Nisur nga kjo propozimi ynë për shpërndarjen e tyre nëpër programet dhe nën-programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike të shpenzimeve, është si vijon:

Paga dhe Meditje në shumën prej **45,000.00 €**;
Mallra dhe Shërbime në shumën prej **65,000.00 €**;
Shpenzimet Komunale në shumën prej **20,000.00 €**;
Subvencione dhe Transfere në shumën prej **24,149.00 €**;
Shpenzime Kapitale në shumën prej **787,972.66 €**.

Në kategorinë paga dhe meditje :

Arsimi Fillor (93510), shuma prej **30,000.00 €**;

Arsimi Mesëm (94710), shuma prej 15,000.00 €;

- **Arsyetim:** Bartje e obligimeve të pashlyera në mësimin për të rritur dhe obligime të zëvendësimit të mësimdhënësve të liruar nga puna për shkak të sëmundjeve të rënda.

Në kategorinë mallra dhe shërbime :

Infrastruktura Rrugore (18018), shuma prej 65,000.00 €;

-Arsyetim: Bartje e obligimeve të pashlyera në mirëmbajtjen e rrugëve lokale.

Në kategorinë e shpenzimeve komunale :

Drejtoria për Buxhet e Financa (17518), shuma prej 10,000.00 €;

Administrata e arsimit (92090) shuma prej 10,000.00 €.

- **Arsyetim:** Bartje e obligimeve të pashlyera për shkak të nxemjeve qendrore me pompa termike dhe rritja e tarifave për shërbimet e pastrimit .

Në kategorinë Subvencione dhe transfere :

Zyra e kryetarit (16018), shuma prej 24,149.00 €;

- **Arsyetim:** Rritja e shpenzimeve për pagesat e lindjeve dhe varrimeve .

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:

Planifikimi urban dhe inspeksion (66395), në projektet:

“Bashkëfinancim me donatorë”, kodi (48267), shuma prej 155,386.49 €;

“Ndërtimi i segmenteve dhe infrastrukturës nëntokësore të rrugës Ymer Berisha, Drini i Bardh, Skender Rexhepi, Abedin Rexha, Mehmet Haxhaj, Haxhi Zeka”, kodi (54272), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Cerovik-Qabiq”, kodi (54276), shuma prej 3,186.17 €;

“Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore ne Kline-Dersnik-Dollc”, kodi (54280), shuma prej 95,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Gremnik”, kodi (54292), shuma prej 4,900.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Jashanice-Jelloc-Resnik-Pogragje”, kodi (54293), shuma prej 45,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Sferke-Volljake-Qupeve”, kodi (54300), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndërtimi i shtratit te Lumit Klina, Lagjja Arberi, Burimi i Jarines-Pograxhe”, kodi (54336), shuma prej 100,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Gjurgjevik te Madhe”, kodi (54337), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Krushev e Vogël(trotuari Kline-Zllakuqan)”, kodi (54341), shuma prej 30,000.00 €

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Poterq-Dugajeve-Drenovc”, kodi (54344), shuma prej 40,000.00 €;

Infrastruktura Rrugore (18018), në projektet:

“Ndërtimi i rrjetit te ndriçimit publik Krushev e Vogel-Madhe,Drenovc,Qeskove, Jashanic, Leskoc, Ranoc”, kodi (54353), shuma prej 52,000.00 €;

“Ndertimi i impijanteve per trajtimin e ujerave te zeza ne Zllakuqan, Jashanice,Shtarice,Gllareve,Radulloc”, kodi (54516), shuma prej 87,500.00 €

Sherbimet Rezidenciale (75587), në projektet:

“Ndertimi i shtepise se pleqeve ne Kline”, kodi (54463), shuma prej 100,000.00 €.

Arsimi Fillor (93510), në projektet:

“Rindertimi i objektit shkollore, Gjimnazi Luigi Gurakuqi”, kodi (54380), shuma 15,000.00 €.

Arsyetim: Në vitin 2023 dhe në vijim inflacioni e ka rritur edhe koston e shpenzimeve. Mbulimi i obligimeve kontraktuale dhe vazhdimin e projekteve të pa përfunduara.

-Komiteti për Politik dhe Financa pas shqyrtimit të propozim-vendimit të drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për bartje të mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2023 në vitin 2024, rekomandoj që i njëjti të kaloj për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 2. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i dytë me qytetar i mbajtur nga kryetari i komunës me datë 26.12.2024,

-Kryesuesi theksoj se sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, kemi obligim ligjorë për shqyrtimin e këtij procesverbalit nga takimi i mbajtur me qytetar nga kryetari i komunës për rrjedhat qeverisëse ashtu siç parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Komiteti për Politik dhe Financa, pas shqyrtimit të procesverbalit nga takimi i dytë i mbajtur me qytetarë nga kryetar i komunës, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim rekomandoj që i njëjti të kaloj për shqyrtim në Kuvend.

Pika 3. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt janar - shkurt 2024,

Kërkesa 1.

Kërkesë e parashtruar nga znj. Samije Gjergjaj e cila thekson se ka 7 vite që vuan nga një sëmundje e rënd (Tumor) dhe se vazhdimisht është dashur që të kryej vizita mjekësore për shërim brenda dhe jashtë vendit, gjithashtu deklarohet se është nënë vetushqyese! Andaj kërkon nga Kuvendi i Komunës së Klinës që t'a ndihmoj me mjete financiare për shërim.

Komiteti për Politik dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. Samije Gjergjaj, rekomandoj që kërkesa për mbështetje financiare për shërim të kaloj për shqyrtim në zyrën e kryetarit, gjithashtu u rekomandua që kjo kërkesë dhe kërkesat e tjera të kësaj natyre të trajtohen me prioritet dhe në mënyrë të veçantë.

Kërkesa 2.

Kërkesë e parashtruar nga znj. Mirjeta Hisenaj e cila thekson se jeton vetëm me një fëmijë në një banesë me qira në qytetin e Klinës, pa të ardhura financiare dhe se ndihma e vetme që merr është nga familja e saj e vajzërisë. Andaj kërkon mbështetje për sigurimin e një banimi social.

Komiteti për Politik dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. Mirjeta Hisenaj, rekomandoj që kërkesa për sigurimin e një banimi social të kaloj për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit dhe në Drejtorin për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të shikohet mundësia e ofrimit të ndihmës për banim me anë të Programit Trevjeçarë për Banim.

Kërkesa 3.

Kërkesë e parashtruar nga znj. Nazife Gucati e cila thekson se është viktimë e dhunës në familje dhe se jeton e vetme me fëmijët në një banesë me qira, andaj konsideron se aktualisht jeton në një gjendje të rënd emocionale, financiare dhe se nuk ka mundësi të siguroj banim të përhershëm. Andaj kërkon nga Kuvendi i Komunës së Klinës që ti ndahet ndonjë banesë apo ti ofrohet strehim i përhershëm pa pagesë.

Komiteti për Politik dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. Nazife Gucati për sigurimin e banimit të përhershëm, të kaloj për shqyrtim në zyrën e kryetarit dhe në Drejtorin për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të shikohet mundësia e ofrimit të ndihmës për banim me anë të Programit Trevjeçarë për Banim.

Kërkesa 4.

Kërkesë e parashtruar nga Prof. Dr. Lush Culaj i cili me rastin e propozimit të dalë nga projekti i aprovuar nga Këshilli Shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës: Ymer Berisha – Jeta dhe veprimtaria atdhetare 1912.1946, kërkon nga Kuvendi i Komunës së Klinës që për veprimtarin dhe atdhetarizmin e tij për interesa nacionale ta dekoroi veprimtarin Prof. Ymer Berishën me dekoratën “Nderi i Klinës”.

Komiteti për Politik dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Prof. Dr. Lush Culaj për dekorimin e veprimtarit të çështjes kombëtare prof. Ymer Berisha me Dekoratën “Nderi i Klinës”. Rekomandoj që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Kuvend dhe të zhvillohen procedurat ashtu siç parashihet me rregulloren për përmbajtjen e simboleve komunale, si dhe për procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera.

Kërkesa 5.

Kërkesë nga Komiteti për Komunitete Kryesuesja e Komitetit: Besiana Gashi

Besiana Gashi, kryesuese e Komitetit për Komunitete, thekson se: që nga viti i kaluar, pavarësisht diskutimeve që i kemi pasur dhe kërkesës në formë ankesë me qëllim të shprehjes së pakënaqësisë për çështjen e mos-pagesës së anëtarëve të këtij komiteti, për të cilët tashmë jeni të informuar edhe ju, ende nuk kam marrë ndonjë përgjigje në formë shkresë zyrtare nga ana juaj si drejtori (Z. Berisha). Andaj, synimi ynë është arritja e një zgjidhje për këtë problem, i cili është me rëndësi për funksionimin e këtij mekanizmi obligativ, siç është Komiteti për Komunitete. Për këtë arsye, me mirëkuptim po kërkoj nga ju, dhe të mundësohet edhe nga kryesuesi i kuvendit (kërkesë Z. Gashi-it), që në mbledhjen e radhës të këtij muaji të na bëni një interpelancë lidhur me këtë çështje, për të marrë informacion në lidhje me hapat konkrete që keni ndërmarrë dhe të na sillni si dëshmi nëse keni ndërmarrë diçka në këtë aspekt.

Komiteti për Politik dhe Financa pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga kryesuesja e KPK-së znj. Besiana Gashi, rekomandoj që kërkesa të kaloj për shqyrtim në Kuvend dhe Kuvendi të ofroj një zgjidhje për pagesat e komiteteve të cilat janë themeluar nga Kuvendi me këtë rast të merret vendim për pagesën e Komiteteve.

Për Kuvendin e Komunës së Klinës

Nga: Samirja Gjergjaj

Klinë: 22.01.2024

Lëndë: Kërkesë për Ndihmë Financiare për Shërim

REK		REK	
KOMUNA E KLINËS		KOMUNA E KLINËS	
Data: 22.01.2024		Data: 22.01.2024	
Nr. Org.	Nr. Org.	Nr. Org.	Nr. Org.
01-553-2496	01-553-2496	01-553-2496	01-553-2496

Pasi që nuk është hera e parë që ju drejtohem, ju njoftoj se gjendja e shëndetit tim secilën ditë e më shumë po rëndohet dhe nuk është stabile dhe në baze të PET-CT-së së fundit, në Sistinë, është konstatuar që dy qeliza tani më janë aktive.

Në prill, të 2023, jam operuar në Amerikë, ku e kam hequr [redacted] dhe pas vizitës në shtator, po në Amerikë, u njoftova se [redacted] të rritet dhe se pas kthimit nga Amerika, gjendja ime u përkeqësua dhe në bazë të komunikimit me onkolog nga Kosova me është rekomanduar PET-CT në Sistinë, ku dhe rezultati nuk është i mirë.

Gjendjen ime shëndetësorë nuk është risi sepse në korrik behën 7 vjet që ballafaqohem me këtë gjendje dhe stafi i Komunës së Klinës është i njoftuar vazhdimisht po ashtu edhe një pjesë që janë anëtar të Kuvendit.

Trajtimi im që nga marsi i 2022, është duke u bërë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku çdo 6 muaj më së paku për 6 jave më duhet të qëndroj për kontrole dhe mjekim, e herë pas herë edhe më gjatë dhe ka një kosto shumë të lartë.

Prandaj, si punëtorë e Komunës së Klinës dhe si qytetar i Klinës, kërkoj nga Kuvendi i Komunës së Klinës, që të më ndihmoj lidhur me financat e shërimit tim, pasi që tani edhe statusi im ka ndryshuar dhe jam edhe Nënë vetushqyese.

Pres që kërkesa ime të merret parasysh.

Dokumentet janë të bashkangjitura në kërkesë.

Mjete mund të transferohen në këtë gjiro llogari: [redacted] EB Banka

Nr. ID: [redacted]

Më respekt

Samirja Gjergjaj

Nr. Tel: [redacted]



NDIHMJA JURIDIKE • PRAVNA POMOC
LEGAL AID

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Agjencia për Ndhimë Juridike Falas-Agencija za Besplatnu Pravnu Pomoć
Agency for Free Legal Aid

KOMUNËS SË KLINËS	
PËR: ZYRËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS z.Zenun Elezi	
PËR: KUVENDIT KOMUNAL KLINË	
PËR: KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA NË KLINË	18.01.2024
PËR: ASAMBLEISTEVE TË KUVENDIT KOMUNAL NË KLINË	
PËR: OJQ-RRJETIT TË GRAVE TË KOSOVËS	
PËR: ZYRES PËR BARAZI GJINORE NË KLINË	
PËR: ZYRËS PËR BARAZI GJINORE znj. Edi Gusia	
LËNDA: KËRKESË -për Strehim të përhershëm	01-360-2176/24

NGA: Nazife Gucati, me nr.personal [redacted] me vendbanim në Klinë, rruga "Abedin Rexhe" K.Klinë, [redacted] parashtron këtë:

KËRKESË

Parashituesja e kërkesës deklaron se aktualisht është e shtyrë në moshë dhe nuk po mundet të gjenë ndonjë Strehim të qëndrueshëm dhe afatgjatë, po ashtu thekson se nuk ka as të mira materiale dhe as financiare, andaj po kërkon të ja mundësoni një Strehim të përhershëm, për arsye se nuk posedon as pronë dhe jeton me Qera aktualisht, andaj konsideron se aktualisht është në gjendje të rëndë emocionale, financiare, dhe nuk po ka mundësi të siguron Strehim të qëndrueshëm.

Prandaj po ju drejtohem me këtë kërkesë në bazë të nevojës urgjente, për arsye se [redacted] dhe po jetoj me vështirësi të mëdha dhe me pamundësi për të gjetur një Strehim të përhershëm.

Unë Nazife Gucati, jetoj në kushte tejet të vështira ekonomiko-sociale dhe shëndetësore dhe nuk kam asnjë burim të të ardhurave nga të cilat do mund të sigurohej mirëqenie për jetën time dhe të dy fëmijëve të mi, të cilët janë në shkollim, andaj po kërkoj të më merrni parasysh dhe të më ofroni ndonjë mundësi të Strehimit të përhershëm, apo të më ndahet ndonjë Banesë, që të siguroj Strehim të përhershëm dhe pa obligime financiare, pasi që kam të rrezikuar mirëqenjen time dhe të fëmijëve.



KOMUNË KLINË

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA LIKA KOSOVA

KLINË

31.01.2024

Mirjeta Hisenaj nga Klina, e lindur me 12.09.1984 në Jashanicë, Komuna e Klinës, rruga: "Dëshmoret e Kombit"-Klinë, pasi që është nënë vetushqyese e cila e mban edhe një fëmijë, lidhur për shkak se nuk ka stehim por banon me qira, duke e ndihmuar edhe familja e vajzerisë, e lidhur me këtë, e ushtron këtë,

K E R K E S Ë

PËR GJETJEN E MUNDESISË NGA KOMUNA E KLINËS, PËR SIGURIMIN E NJË BANESË APO SHITËPIE NË QYTETIN E KLINËS, PASI QË MOMENTALISHT BANOJ ME QIRA POR MJETË PËR JETESË

01-360-3352/24

Fillimisht duhet të deklaroj se kam qenë e martuar me një burrë nga fshati Izbicë, Komuna e Skenderajt por pasi që nuk mundem të mirremi vesh ndermjet veti vendosem që të shkurorëzohemi, ku tre fëmijet e ka në rritje dhe edukim ai kurse unë e kam një-fëmijën e vogël.

P r o v ë: Aktgjykimi i Gjykatës themelore Mitrovicë-dega në Skenderaj, nga gjyqtari Harullah Aruqi.

Unë e kam marr një banesë me qira, në Klinë, rruga: "Dëshmoret e Kombit" me çmim prej 165 euro në muaj dhe jetoj e vetme vetem me një djalë i cili ika një vit e gjysmë dhe shpenzimet e qirës mi paguan familja e vajzerisë nga Jashanica dhe aktualisht jam e pa punësuar. Si nënë vetushqyese e kam shumë vështirë për të kaluar muajin sepse e kam edhe fëmijën tim, për të cilin duhet përmbushur shumë kërkesa për mbajtjen e tij, për përkujdesjen e tij.

P r o v ë: Kontrata e qirës për banim në një banesë në rrugën: "Dëshmoret e kombit"-Klinë.

Pagesa e qirës, ushqimi, veshmbathja për mua dhe djalin, shpenzimet komunale, uji, mbeturinat, të domosdoshme për jetë, për mua si nënë vetushqyese janë të papërballueshme. Kërkesa e imja, pasi që jam nënë vetushqyese, sigurimi i një banese për stehim apo shtëpi por nuk kam prona timen në të cilën kisha me e nderuar një shtëpi banimi dhe për momentin jetojmë e vetme me djalin tim pa asnjë të ardhur personale por vetëm me ndihmën e familjes së vajzerisë, kur dihet se ata mezi jetojnë vet e edhe unë ti behem barrë e tyre.

Nën përgjegjësinë, penale, materiale dhe morale deklaroj se unë po jetoj me kushe shumë të vështira e të pa përballueshme, për këtë arsye po ju drejtohem juve, në mënyrë kërkesen time ta shqyrtoni dhe pas shqyrtimit të vendosni për një banim, qofte social apo diq tjetër sepse gjendja po vjen për çdo ditë duke u rënduar por edhe familja ime e vajzerisë nuk kanë mjete për të me ndihmuar mua, prandaj kërkoj nga kompetentet që të marrin urgjentisht nevojën time për një stehim sa më urgjent, duke me siguruar një strehim të përhershëm.

Me shpresë se kërkesa ime të shqyrtohet dhe si e tillë të vendoset meritorisht, ju përshendesim!

Dashkangjitur: 1. Kopjen e Kontrates së qirës, ku shihet se unë jetoj me qira në banesën e Beqir Dragidellës, nga data 31.08.2-22 e deri me sot, me çmim të qirës fillimisht 150 euro tani 165 euro.

2. Ekastraktin ga regjistri qendror i gjendjes civile,

3. Certifikata e lindjes,

4. Aktgjykimin nga 05.03.2022, i datuar 31.05.2022, me të cilin deshmohej se unë jam shkurorëzue nga ish bashkeshorti im nga Izbica, Komuna e Skenderajt, i marr nga Gjykata themelore Mitrovicë-dega në Skenderaj nga gjyqtari, Hajrullah Aruqi.

5. Kartonin e ndihmes sociale nga Qendra për punë Sociale me seli në Klinë dhe

6. Kopja e letërnjoftimit.

Klinë, me 31.01.2024

PARAQITESJA E KËRKESËS,
Mirjeta/Sadik/ Hisenaj nga Klina, Komuna e Klinës,
Me nr. person. 1032811021 IPB. Kosovë,
Me nr. tel. 069 335 21 24

**TË DHËNAT PËR PËRZYMESIN
EDOKIM KOSUNIKU**

Emri / Prezime: H. Senaj
Emri / Emë: M. J. J. J.
Adresa / Mbrojtja: Kline
Të përdorur / Të përdorur: [Redacted]

Shtetësi e vart dhe datat e lindjes për të gjithë
shtetësit në familje
Shtetësi i vart dhe datat e lindjes për të gjithë
shtetësit në familje

Dianant 2022

[Signature]

[Stamp]

**UDHËZIME PËR SHËRBYMIMIN E PAGESAVE
UPUTSTVO ZA SLUŽBE KOJE VRŠI ISPLATE**

Kjo kartelë e shërbimit të ndihmës sociale duhet të tregojë se bashkë
me dokumentin identifikues para se shërbimet të bëhen pagesa.
Ora kartela kodifikon secilin përkrahje se të identifikojë pre-
tensionin e tyre.

Kjo shërbim nuk bëhet në gjendje që të vë në ditë të punës pagesën,
mund të vë në ditë të punës pagesën për personin që ka pagesën për të
marrë pagesën duhet të tregojë dokumentin identifikues para se të bëhet pagesa.
Nëse kartela nuk u tregon datën e lindjes të tyre, mund të vë në ditë të punës
për personin që ka pagesën duhet të tregojë dokumentin identifikues para se të bëhet pagesa.
Nëse kartela nuk u tregon datën e lindjes të tyre, mund të vë në ditë të punës
për personin që ka pagesën duhet të tregojë dokumentin identifikues para se të bëhet pagesa.

VERIFIKESJA: Kjo kartelë e ndihmës sociale duhet të tregojë shërbimet dhe
shërbimet e familjes që të tregojë që të tregojë nga pagesa e përdorimit
për shërbimet shërbimet.
NAPOMENA: Ora kartela sociale e përkrahjes së shërbimit të ndihmës sociale
nëse paraqet ose ka pagesën për pagesën e shërbimit të ndihmës sociale
nëse paraqet ose ka pagesën për pagesën e shërbimit të ndihmës sociale.

**MIRËQENIA SOCIALE
SOCIALNA POMOC**

**KARTELA E NDHIMËS SOCIALE
KATEGORIA NJË (1)
KARTON SOCIALNE POMOCI
KATEGORIJA (1)**

Qendra për Punë Sociale / nënzyra: Kline
Centra za Socialni Rad U:
Numri i regjistrimit në NS: 55468
Socialna pomoc (S/S) br:

Data e lëshimit / Datum izdavanja: 10.10.02.

Nëpunësi i ndihmës sociale që e ka lëshuar kartelën
Službenik socialne pomoći koji je izdao kartiku

Emri dhe mbiemri
Ime i prezime: V. Marku

Nr. ID
Br. ID: 193

Nënkërkimi
Potpis: [Signature]

Form.: SNS-SSZ: 004

**TË PLOTËSOHET NGA NËPUNËSI I NDHIMËS SOCIALE NË QENDRËN PËR PUNË SOCIALE
POPUNJAVA SLUŽBENIK ZA SOCIALNU POMOC U CENTRU ZA SOCIALNI RAD**

Koha e vlefshmërisë Rok važenja	Shuma e ndihmës sociale EURO IZNOS SOCIALNE POMOCI U EVRIMA	Emri i nëpunësit të ndihmës sociale (NNS) IME SLUŽBENIKA SOCIALNE POMOCI (SSP)	Nr. personal i NNS BRIG. ID. SSP	Nënkërkimi i NNS POTPIS SSP	Vula e QPS dhe nënkërkimi i personit që e vulos kartelën PECAT CSRTI POTPIS LICA KOJE JE OVERILO KARTIKU PECATOM
Pril/Od: <u>10.10.23</u> Deri/Do: <u>07.10.24</u>	<u>100</u>	<u>V. Marku</u>	<u>193</u>	<u>[Signature]</u>	<u>[Stamp]</u>
Pril/Od: <u>1/1</u> Deri/Do: <u>1/1</u>					
Pril/Od: <u>1/1</u> Deri/Do: <u>1/1</u>					
Pril/Od: <u>1/1</u> Deri/Do: <u>1/1</u>					
Pril/Od: <u>1/1</u> Deri/Do: <u>1/1</u>					

Numri i lëndës: 2022:066148
Datë: 03.06.2022
Numri i dokumentit: 03093736

par.2 i Ligjit për Familjen i Kosovës nr.2004/32. Ku shprehimisht thuhet "Shkaqet e shkurorëzimit në mes tjerash janë: jeta e pa durueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, vepra penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qellim keq dhe e pa arsyeshme, sëmundja psikike e pa shërueshme dhe paafësia e vazhdueshme për të vepruar, ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme".

Kontaktet personale të paditëses me fëmijët duhet do të mbahen në Qendrën për Punë Sociale në Skenderaj ashtu si është përcaktuar në paragrafin tre në dispozitiv të këtij aktgjykimi nga se fëmijët e mitur ka nevojë emocionale të ketë kontakte me prindin e tij sidomos nënën për shkak të ndjenjave emocionale, prandaj gjykata duke u bazuar në të gjitha rrethanat e rastit konkret, moshën e fëmijve për kontaktet vendosi në përputhje me dispozitat e nenit 140 të LFK-së.

Sa i përket kthimit të mbiemrit të vajzërisë paditësja mund të bëjë këtë në procedurë administrative në Shërbimin e Ofiqarisë duke u bazuar në dispozitat e nenit 96 të LFK-së.

Vendimi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës është bazuar në dispozitat e nenit 452 par. 2 dhe nenit 347 të LFK-së.

Më sa u tha më lartë konform dispozitave ligjore të përmendura më lartë dhe dispozitave të nenit 143 të LFK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.85/2022 me dt.31.05.2022

Kryetari i trupit gjykues
Hajrullah Aruqi

KËSHILLË JURIDIKE: Aktgjykimi është i formës së prerë nga data 31.05.2022, pasi që palët kanë hequr dorë nga e drejta në Ankesë.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA SKENDERAJ
OBNOVNI SUD MITROVICA DEGA SKENDERAJ
MITROVICE - MITROVICA

Mo
Data

31.05

22

Republika e Kosovës Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

Hajrullah Aruqi

Gjykata duke u bazuar në nenin 68 paragraf 4, i Ligjit mbi Familjen e Kosovës, (Ligji 2004/32) në të cilën përcaktohet nëse njëri nga bashkëshortet paraqet padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti deri në përfundimin e seancës kryesore deklaron shprehimisht se nuk e kundërshton bazushmerin e kërkesëpadisë do të konsiderohet se bashkëshortet kanë paraqitur propozimin për shkurorëzim me marrëveshje.

Gjykata me qëllim të konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në çështjen konkrete juridike në kuptim të nenit 7 dhe 8 të LPK-së i nxori dhe administroj të gjitha provat e propozuara nga palët ndërgjyqës të evidentuara në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor me dt.31.05.2022 një nga një dhe të gjitha se bashku duke i krahasuar njëri me tjetrin nga të cilat rezultojnë se kërkesëpadia e propozueses është e themelte.

Palët kanë lidhur martesë në ZGJC në Skenderaj me dt.10.03.2021 e cila martesë është regjistruar në LAM me nr.ref. [REDACTED] dhe nr.rend.17 në mes të Mirjeta Kallamaku e lindur me dt.12.09.1984 në Jashanicë me nr.për. [REDACTED] me vendbanim në Jashanicë shtetase e Republikës së Kosovës nga i ati Sadik dhe e ëma Raba dhe Ibush Hisenaj i lindur me 01.03.1975 në Skenderaj nr.pers. [REDACTED] me vendbanim në Skenderaj shtetas i Republikës së Kosovës nga i ati Hashim dhe ëma Hava. Paditësja me rastin e lidhjes së martesës e ka marrë mbiemrin e bashkëshortit Hisenaj.

Ky fakt është vërtetuar përmes Certificate e Martesës nr.ser. [REDACTED] dt.23.03.2022.

Sa i përket marrëdhënieve bashkëshortore gjykata konstaton se që nga fillimi i martesës raportet bashkëshortore nuk kanë qenë të mira dhe në pamundësinë e normalizimit të tyre ka filluar të marrin karakter të përhershëm dhe të vazhdueshëm për këtë shkak ka pasur dhunë në familje prandaj kjo gjykatë me Aktvendimin C.nr. [REDACTED] të dt.23.02.2022 ka lëshuar urdhrin për mbrojtje për shkak të ushtrimit të dhunës fizike dhe psikike ndaj palës së mbrojtur nga pala përgjegjëse tani i padituri. Në rastin konkret gjykata konstaton se i padituri i ka dhënë shkak çrregullimit të raporteve bashkëshortore.

Për këto arsye të cekura më lartë bashkëshortët jetojnë të ndarë, ndërsa fëmijët e përbashkët jetojnë te i padituri.

Në bazë të provave të administruara gjykata erdhi në përfundim se martesë nuk e ka arritur qëllimin për të cilin është lidhur që është jeta e përbashkët krijimi i familjes, marrja përsipër e të gjitha të drejtave dhe të detyrimeve që dalin nga martesë. Vazhdimi i kësaj martesë më tutje është bërë i pamundur.

Nga këto arsye gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e mbështetur plotësisht në provat e administruara dhe në dispozitat e nenit 69



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

REPUBLIC OF KOSOVO GOVERNMENT MINISTRY OF JUSTICE Court of First Instance	
Case No.	04
File No.	818
Date	09.06.2022

Numri i lëndës:

Datë:

03.06.2022

Numri i dokumentit:

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, në trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Hajrullah Aruqi-kryetar, gjyqtaret porotë Nexhmije Reci dhe Hysen Kuqi me bashkëpunëtorin profesional Shpresa Shala-Istrefi në çështjen juridike të propozueses Mirjeta Hisenaj e vajzërisë Kallamaku me numër personal [redacted] me vendbanim në fshatin Jashanicë, komuna Klinë të cilën e përfaqëson av.Gani Veseli me seli në Skenderaj dhe propozuesit Ibush Hisenaj me numër personal [redacted] nga fshati Izbicë, komuna Skenderaj të cilin e përfaqëson av.Kadri Osaj me seli në Mitrovicë, për shkak të zgjidhjes së martesës pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor me pjesëmarrjen e palëve ndërgjyqëse me dt.31.05.2022 merr këtë :

AKTGJYKIM

I. ZGJIDHET Martesa në mes të propozuesve Mirjeta Hisenaj e vajzërisë Kallamaku e lindur me dt.12.09.1984 në Jashanicë, nga i ati Sadik dhe e ëma Raba dhe propozuesit Ibush Hisenaj i lindur me dt.01.03.1975 në Izbicë nga i ati Hashim dhe e ëma Hava, LAM sipas Certifikate e Martesës nr.ref. [redacted] nr. rend. 17 e dt. 10.03.2021, për shkak të çrregullimit të marrëdhënieve martesore në mënyrë serioze të vazhdueshme dhe ndërprerjes së jetës së përbashkët faktike.

II. Fëmijët e përbashkët Korab Hisenaj i lindur me dt.31.05.2010 në Prishtinë, Erlisa Hisenaj e lindur me dt.17.08.2011 në Prishtinë, Halim Hisenaj i lindur me dt.07.06.2013 në Skenderaj, i besohen në ruajtje, edukim dhe ushqim propozuesit-babait Ibush Hisenaj.

III. Kontaktet e propozueses-Mirjeta Hisenaj me fëmijët caktohen të mbahen të Premten e parë dhe të dyte të muajve vijues në Qendrën për Punë Sociale në Skenderaj prej orës 14:30 deri në orën 16:30, në ditëlindjen e fëmijës, gjatë festave shtetërore dhe fetare.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Numri i lëndës: 2022:066148
Datë: 03.06.2022
Numri i dokumentit: [REDACTED]

A r s y e t i m

Paditësja përmes përfaqësuesit të tijë në padinë e ushtruar në gjykatë me datë 24.03.2022 ka theksuar se me të paditurin e kanë lidhur martesën më dt.10.03.2021 e cila martesë është regjistruar në LAM me nr.ref. [REDACTED] dhe nr.rend.17. Nga kjo martesë e kemi të lindur fëmijët e përbashkët Korab Hisenaj, Erlisa Hisenaj, Halim Hisenaj. Paditësja me të paditurin e kanë lidhur martesën me qëllim të krijimit të familjes së përbashkët dhe martesa ta arrijë qëllimin e saj fillimisht raportet kanë qenë të mira në ndërkohë erdhi tek përkeqësimi i marrëdhënieve bashkëshortore me të paditurin, dhe nuk kanë mundur ti rregullojnë raportet ku dhe kanë shkëputur jetën faktike paditësja tani gjendet tekë familja e saj në Jashanic, dhe kërkon që kjo martesë të zgjidhet me shkurorëzim dhe ti mundësohet takimi me fëmijët pasi që nga dalja nga shtëpia nuk ka pasur kontakte me ta.

Gjykata pas pranimit të lëndës me dt. 17.05.2022 ka kërkuar nga QPS-Organi i Kujdestarisë që të përpilojë raport me shkrim rreth mundësisë së arritjes së pajtimit dhe rreth besimit të fëmijëve.

QPS-Organi i Kujdestarisë me dt. 25.05.2022, ka kthyer përgjigje me konstatimin se procedura e pajtimit mes bashkëshorteve Mirjeta Hisenaj e vajzerisë Kallaku dhe Ibush Hisenaj ka dështuar.

Gjatë shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i paditëses deklaroi se mbeti pranë padisë edhe kërkesë se saj duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadia të aprovohet e bazuar dhe martesa të zgjidhet me shkurorëzim për arsyeje se nuk ka mbetur asnjë shprehje që të vazhdohet jeta bashkëshortore, sa i përket fëmijëve gjykatës i propozoj që në bazë të ligjit të përcaktohet edhe mënyra e besimit dhe kontaktit të fëmijëve, pasi që ish bashkëshorti i fëmijëve nuk mundëson kontaktin e fëmijëve, shkaqet dhe arsyet ika dhenë edhe QPS-së në Skenderaj. I propozoj gjykatës aprovimin e padisë si të bazuar, heqim dorë nga ankesa në aktgjykim.
Shpenzimet e procedurës nuk i kerkoj.

Përfaqësuesi i të paditurit në shqyrtimin kryesor u deklaruar se pas njoftimit me shkresat e lëndës dhe konsultimit paraprak me klientin tim, sa i përket padisë lidhur me shkurorëzim gjykatës i propozoj që të konsiderohet si propozim i përbashkët për zgjidhjen e martesës. Sa i përket fëmijëve paditësi i propozon gjykatës që fëmijët ti besohen në ruajtje, edukim dhe përkujdesje paditësit si baba i tyre, sa i përket kontaktit paditësi gjithmonë ka qenë bashkëpunues eka respektuar urdhrin e shqiptuar nga gjykata dhe vazhdimisht fëmijët ika sjell në QPS-së por fëmijët kanë qenë ata që nuk kanë dëshiruar që të takojnë nënë e tyre, konkluzioni e kem pranuar dhe kerkojm që të vendoset në bazë të konkluzionit sa i përket besimit të fëmijëve. Andaj propozojmë gjykatës që të zgjidhet martesa me shkurorëzim, heqim dorë nga ankesa në aktgjykim.

Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

KONTRATË për BANES

MBI QERANË E BANESES NË KLINË Rr: "Dëshmoret e Komitit" - Klinë

E lidhur me dat 31.8.2022 në Klinë në mes të 1. Besim H. Dragidella nga Klina si qeradhenës
i BANESES në Klinë, si dhe 2. Mirjeta Kallamasha Komuna Klinë si
qeramarrës në anën tjetër.

Kontrata ka të bëjë me sa vijon

1. Kontraktuesi i parë Besim H. Dragidella në tekstin e metut/jeshëm qeradhenësi është pronar i BANESE, i cila gjendet në Klinë rr. "Dëshmoret e Komitit" nr. në sip. 50 prej , i cili leshon për qera mujore prej 165,00 Euro, qeramarrësi duhet të paguaj edhe kaucionin prej 150, Euro. Në qoftesë banesa është në rregull kaucioni do të kthehet në të kundërtën ndalet sipas çmimit të armatizuar të banesës.
2. Qeramarrësi obligohet që qeranë mujore në lartësinë e cekur të ia paguaj qeradhenësit në të gatqme në dorë në fillim të çdo muaji e më se largu deri me dat. 03 të muajit vijues për muajin, kështu duhet të bëjë parapagim edhe për një muaj.
3. Kontraktuesit këtë kontratë e lidhin me dat. 31.8.2022 për , në rast se palet nuk janë në ujdi mund të lidhin kontratë të re mbi qeranë dhe me kushte të tjera.
4. Qeradhenësi dhe qeramarrësi duhet se paku 3 muaj ta paralajmëroi njeri-tjetrin për leshim të objektit.
5. Qeramarrësi nuk ka të drejtë të ja leshoj personi të tretë me qera BANESEN si nga pika 1.e kesaj kontrate. Qeramarrësi ka për obligim të paguaj enë, gjinë elektrike të shpenzuar KEDS-it, po ashtu ka obligim të paguaj shpenzimet e ujit si dhe mbeturinat, kurse tatimin e pronë e paguan qeradhenësi.
6. Në rast të leshimit të BANESES shpenzimet për energji, ujë dhe mbeturina, lysterje të banesës demtim të eventarit të banjos duhet ti ketë të paguara të (shlyera) në tërësi pasi janë obligim i qeramarrësit.
7. Nëse palët pelqejnë dhe e prishin këtë kontratë atëherë qeramarrësi e liron BANESEN në gjendjen e pranimit dhe për çdo dëm të demtuar qeramarrësi obligohet ti sanoj vetë me shpenzime të veta, në të kundërtën qeradhenësi ka të drejtë të kërkoj saminin e tyre në rrugë gjyqësore.
8. Kjo kontratë është përpiluar në kopje të mjaftueshme identike nga një për secilen pal kontraktuese, kurse tjerat organe kompetente, e cila në shenjë miratimit të nënshkruhet pa vërejtje nga palet kontraktuese pas leximit të saj.

KONTRAKTUESIT: Arsim Dragidella

Me ID.Nr. 1171360605, leshuar nga Rep.e Kosovës

2. QERAMARRËSI:

Mirjeta Kallamasha

Me ID.Nr. , leshuar nga Rep.e Kosovës

Dr. Laci Shkurtaj